

Aleanca Kosova e Re – AKR

Për një Fillim të RI

Me një Vizion të RI

Për një KOSOVË të RE



Të nderuar qytetar,

Pas një pune të palodhshme të ekspertëve që veprojnë në kuadër të AKR-së, me potencialin e tyre profesional dhe vullnetin e mirë për një Kosovë të re, mundësuan që tani projekti ynë të jetë udhërrëfyes konsekuent i veprimeve dhe punës tonë. Projekti është i thjeshtë, praktikë, i kuptueshëm dhe mbi të gjitha është zgjidhja ma e mirë e halleve dhe preokupimeve tona afatshkurtra dhe afatgjata. Njerëzve të vullnetit të mirë që ardhmërinë e tyre e shohin vetëm përmes djersës dhe punës, ne u hapim derën që të na bashkohen dhe ta ndërtojmë me plot përgjegjësi dhe me një profesionalizëm transparent Kosovën e re.

Cila është përgjigjja në pyetjet për nevojat e fëmijëve dhe të rinjve tonë, nevojave elementare të familjeve tona, pastaj nevojave të veteranëve të luftës dhe invalidëve me aftësi të kufizuar, nevojave të pensionistëve dhe mjekëve, studentëve dhe mësuesve, amviseve dhe grupeve marginale, policëve dhe ushtarakëve, shërbyesve civil si dhe familjeve të dëshmorëve dhe fëmijëve bonjak, së bashku me kategoritë tjera të rrezikuara për kafshatën e bukës?

Për ta kuptuar më mirë këtë realitet të hidhur, ne jemi futur në qenien e një njeriut të rëndomtë për të kaluar ditët me të dhe për tu ballafaquar me problemet që e mendojnë sot një qytetarë të Kosovës. Ato janë anomali të neveritshme që janë bërë pa dashje pjesë e përditshme e një jete në Kosovë. Që nga momenti i largimit nga shtëpia, qytetari i Kosovës, ballafaqohet me vështirësi banale, me rrugë nëpër të cilat derdhen ujërat e zeza, me trotuar të cilët janë shndërruar në parkingje ndërsa ai detyrohet të ecë nëpër rrugët ku qarkullojnë makinat, me pritje të gjata të transportit publik, me mito për shërbime shëndetësore, dhe kthimin në shtëpi me duart thatë. Pastaj pritjet e neveritshme në mbrëmje që fëmija të kthehet në shtëpi nga ndërrimi i katërt i shkollës fillore dhe ndërprerjet e rregullta të energjisë elektrike. Imagjinojeni qytetarë të nderuar, vetëm për një moment qytetin Tuaj nga prizma e një personi të vendosur në karrocë dhe do të shihni atë që kemi parë ne – se sa e padurueshme dhe papërballueshme është infrastruktura jonë publike. Ky është një realitet i hidhur i qytetarit të Kosovës, kjo është përditshmëria e tij dhe ai me të drejtë pret një përgjigje në pyetjen e tij shumë të thjeshtë: Pse po ndodhe kjo dhe si të tejkalohet një situatë e tillë. Në vende të civilizuara, zakonisht për të

gjitha këto pyetje përgjigjen qytetarët do ta gjenin tek Qeveria e vendit. Por, në Kosovën e pasluftës përgjigjen nuk do ta gjeni aty! Ne dhe Kosova, jemi duke i përjetuar momentet më kritike, qytetarë të nderuar!

Këtë nuk e kemi merituar!

Nuk e kemi merituar as papunësinë mbi 50%, më të lartën në Evropë: nivelin më të ulët të standardit jetësor prej luftës e këndeje, varfërinë e skajshme me mbi 20%:, shkallën më të dobët të cilësisë së edukimit dhe arsimit: cilësinë e ulët të përkujdesit shëndetësorë: keq menaxhimin e jetës dhe pronës sonë: raportet ndër njerëzore te çrregulluara tej mase: humbjen e besimit tek autoritetet politike e publike: shtrenjtimet e përditshme të artikujve themelorë për jetë: papërgjegjësinë e madhe të institucioneve: krizën e thellë morale në familje dhe shoqëri: ndihmën shumë të ulët sociale: marginalizimin e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës: krimin e organizuar: korrupsionin kërcënues në gjithë shoqërinë: shpëputjen e lidhjeve mes qytetarit dhe institucioneve: mungesën e shtetit ligjor: joefikasitetin e institucioneve: infrastrukturës dhe ambientin e padenjë: me probleme banale (uji, kanalizimi, mbeturinat, rruga, siguria, rryma elektrike, e shume e shume tjera).

Të jemi të vetëdijshëm! Ne tani Ju ftojme në zgjedhje, jo vetëm për ne, por për fëmijet tanë, të cilët do të pyesin një ditë çfarë bëtë për ne? Ata do të kërkojnë padyshim llogari nga ne!

Përkushtimi im dhe zgjedhja e JUAJ është përgjigjja më e drejtë.


E falënderoj Perëndinë që ma dha rastin t'i ofroj sot Kosovës një vizion të ri e ta jap kontributin tim. Duke Ju falënderuar Juve, në rend të parë, dhe bashkëpunëtorëve të mi të ngushtë, kam nderin dhe kënaqësinë ta shpaloj projektin e AKR-së, që është edhe përcaktimi dhe agjenda e veprimeve tona, e njëkohësisht edhe Program Qeverisës i AKR-së.

Ky projekt paraqet detyrimet dhe obligimet tona ndaj Jush, të cilat do t'i implementojmë me sinqeritet, transparencë, përgjegjësi dhe në afat të caktuar kohor.

*Projekti i AKR-së, i nënshkruar, le të jetë një Kontratë ndërmjet AKR-së-meje dhe Jush.
Ju garantoj se kjo kontratë që do ta lidhim midis jush qytetarë të nderuar dhe AKR-së
do të realizohet tërësisht!*

*Zotohem, se projektin që Ju e keni në duart Tuaja do ta bëj të realizueshëm me ndihmën
dhe përkrahjen Tuaj. Andaj, të nderuar qytetarë, na lejoni t'ia fillojmë **punës!**
Zoti na ndihmoftë në rrugëtimin tonë të përbashkët!*

Aleanca Kosova e Re

A handwritten signature in black ink on a light blue background. The signature is stylized and appears to be the name 'M. Alami'.

Projekti për Kosovën e Re

Përmbledhje

Të nderuar qytetarë,

Ka tetë vite që kosovarët keqqeverisen nga qeveri jofunksionale. Koalicionet e deritanishme kanë qenë të dizajnuara për të mos funksionuar. Dobësimi i skajshëm i pozicionit të kryeministrit dhe bartja e llogaridhënies tek udhëheqësit partiak kanë paralizuar ekzekutivin dhe kanë krijuar qeveri brenda qeverisë. Mungesa e hierarkisë është pasuar më mungesë të definimit të detyrave dhe përgjegjësive si në nivel qendror ashtu edhe lokal. Kjo i ka hapur të gjitha dyert korrupsionit, keqpërdorimeve, jotransparencës dhe mosrespektimit komplet të qytetarit. Në vend të vendosjes së aparatit publik në shërbim të qytetarit, detyra është keqpërdorur për interesa klanore. Në vend të mirëqenies, qeveria ka prodhuar varfëri; në vend të vendeve të punës është prodhuar papunësi; në vend të respektimit të qytetarit është ofruar poshtërimi i tij.

Për tetë vite me radhë qytetari ynë ka përjetuar degradim të vazhdueshëm, keqpërdorim të tatimeve të paguara, diskreditim komplet të imazhit të shtetit dhe ka shtruar vetëm një pyetje: deri kur? Aleanca Kosova e Re e bindur se një qeverisje e tillë është e dënuar të dështojë ka përgjigjen e saj. **Koha është tani. Jo për ta kritikuar qeverinë, por për ta ndërruar atë. Është koha që vendi të frymojë përsëri.** Që qytetarit t'i kthehet dinjiteti, shpresa dhe perspektiva.

Alenaca Kosova e Re dështimit i përgjigjet me vision për sukses; korrupsionit i përgjigjet me luftë të pakompromis; stagnimit me reformë rrënjësore; papunësisë me investime, izolimit me integrim; pasigurisë me siguri; kaosit me llogaridhënie; anarkisë me definim të qartë të detyrave dhe përgjegjësive. Si qytetari ashtu edhe shtyllat e qeverisjes do të udhëhiqen nga raporte të shëndosha të të drejtave dhe detyrimeve.

Vizioni ynë i ri mbi qeverisjen funksionale është garant për sukses. **Thelb i suksesit është modeli i ri i udhëheqjes në ballë të të cilit vendoset Leviatani, Presidenti i shtetit i zgjedhur me votën e drejtpërdrejtë të qytetarëve. Ne ofrojmë një president që garanton respektimin e qytetarit, që garanton sinergji të shëndoshë të institucioneve publike.** Presidenti i dalë nga vota e popullit do të disponojë me mekanizma që i mundësojnë atij mbikëqyrjen e performancës së shtyllave tjera të qeverisjes si legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësia si dhe parandalimin e keqpërdorimeve të funksioneve në to.

AKR ofron një administratë publike të reduktuar por funksionale. Qeveria e udhëhequr nga AKR do të ketë vetëm 6 departamente që do të koncentrojnë në vete të gjitha sektorët e një qeveria efektive. Vizioni ynë është kualitet e jo kuantitet. Mbështetje në ligje të thjeshta dhe të kuptueshme për qytetarin. Departamentet tona do ti menaxhojnë aktivitetet në fusha me rëndësi si Ekonomia dhe financat; Puna dhe shërbimet publike; Arsimi, kultura, rinia dhe sporti; Drejtësia; Mbrojtja dhe siguria dhe Politikat e jashtme. Për secilin departament AKR ofron vizion të qartë të synimeve dhe aktiviteteve. Këto synime dhe aktivitete janë të radhitura si vijon:

| | |
|---|-----------|
| I. Departamenti për Ekonomi dhe Financa..... | 8 |
| II. Departamenti i Punës dhe Shërbimeve Publike..... | 18 |
| III. Departamenti i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit..... | 32 |
| IV. Departamenti i Drejtësisë | 44 |
| V. Departamenti i Mbrojtjes dhe Sigurisë..... | 47 |
| VI. Departamenti i Politikave të Jashtme..... | 51 |

T'ia fillojmë punën

I. Departamenti për Ekonomi dhe Financa

Aleanca Kosova e Re është e vetëdijshme se rritja e qëndrueshme ekonomike paraqet pikënisje të çdo politike që ka në qendër të saj mirëqenien e qytetarit. Zvogëlimi i varfërisë, ulja e pabarazisë dhe reduktimi i diferencave në zhvillim me vendet e rajonit, janë të mundshme vetëm duke shtuar nivelin e produktit shoqëror.

Ky synim pastaj lehtëson shumë edhe realizimin e prioriteteve tjera, para së gjithash uljen e nivelit të papunësisë, përmirësimin e nivelit të edukimit dhe shëndetësisë, lehtëson tërheqjen e investimeve të huaja, forcimin e sundimit të ligjit, forcimin e pushtetit në nivel lokal, përshpejton procesin e integritit të vendit në BE , e të tjera.

AKR i drejtohet qytetarëve me një ofertë konkrete, të mirëmenduar dhe të realizueshme, me objektiva të qarta të rritjes së qëndrueshme të mirëqenies dhe me mekanizma efikas e transparent. Oferta jonë përfshinë të gjitha ato sfera ku qeveria funksionale mund të ndikojë në përmirësimin e kushteve për biznese dhe në ngritjen e aftësisë së tyre konkurruese. Kjo ofertë përfshinë politikat fiskale dhe monetare të vendit; privatizimin dhe politikat për tërheqjen e investitorëve të huaj, politikat për mbështetje të bujqësisë, krijimin e infrastrukturës kualitative publike, rregullimin e kornizës ligjore për funksionimin e konkurrencës së lirë dhe ekonomisë së tregut, rritjen e stabilitetit të sistemit financiar të vendit dhe rritjen kualitative të vëllimit të kredisë për bizneset që gjenerojnë vende të reja të punës.

AKR është e bindur se bazë për sukses për secilën nga politikat e implementuara është evidenca e plotë e popullsisë së Kosovës, karakteristikave ekonomike dhe shoqërore dhe shpërndarjes gjeografike të saj. Andaj premtojmë se menjëherë pas marrjes së mandatit nga qytetari do të fillojmë me regjistrimin komplet të popullsisë dhe ekonomive familjare.

Një nga barrierat kryesore për rritje ekonomike në Kosovë është e qasja e pamjaftueshme e bizneseve në tregun e kapitalit, kushtet e pavolitshme të kredimarrjes dhe shpërndarja jo

efikase e kredive. Në qendër të politikave tona ekonomike është krijimi i një banke investive, përmes së cilës aktivisht dhe fuqishëm do të mbështesim aktivitetet ekonomike në fushat prioritare për zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo bankë do të menaxhojë pjesë të fondeve të akumuluar të agjensioneve ekzistuese kosovare, pjesë të buxhetit të Kosovës të dedikuara për investime publike por edhe fonde të disbursuara nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat e huaja investive.

AKR është e vetëdijshme për faktin se resurset e pasura me të cilat disponon vendi i takojnë njësoj si gjeneratave ekzistuese ashtu edhe pasardhësve tanë, andaj del me ofertë konkrete për një shpërndarje më të drejtë të përfitimeve nga shfrytëzimi i këtyre pasurive. Do të krijojmë Agjencinë e Akumulimeve (Agjencinë për Gjeneratat e Ardhshme), ku do të depozitojmë një pjesë të të hyrave nga shfrytëzimi i resurseve të shtjerrshme.

Prioritetet e AKR-së në politikat fiskale dhe monetare

Për të arritur synimin primar të ngritjes së mirëqenies ekonomike të qytetarit nevojiten edhe ndryshime të kujdesshme si në politikat tatimore ashtu edhe në rishpërndarjen e buxhetit të vendit. Në politikat tatimore do të veprojmë drejt eliminimit të mangësive në legjislacionin ekzistues, thjeshtësimit të tij, uljes së normave tatimore, ashpërsimit të sanksioneve për mospërbushje të obligimeve tatimore, ngritjes së kapaciteteve implementuese të administratës tatimore, edukimit të vazhdueshëm të tatimpaguesit, fuqizimit të komunave me të hyra vetanake dhe ofrimit të lehtësimeve tatimore për sektorë, lokacione dhe periudha të caktuara. Oferta jonë në këtë fushë është shumëdimensionale, e kuptueshme, e realizueshme dhe produktive:

- Do të bëjmë një rishikim komplet të legjislacionit ekzistues tatimor me synim të modernizimit të tij, thjeshtësimit, eliminimit të kontradiktave të pranishme, uljes së hapësirave manovruese të inspektorëve tatimor, ridefinimit të qartë të të drejtave dhe detyrimeve të tatimpaguesve.
- Sistemi tatimor do të dizajnohet në atë mënyrë që minimizon shtrembërimet ekonomike, në mënyrë që alokimi i resurseve të vendit të ndikohet sa më pak.

- Ligji për tatimin në të hyrat personale do të thjeshtësohet dukshëm duke vendosur një shkallë të vetme tatimore për të gjitha burimet e të hyrave, e cila do të jetë e njëjtë me atë të tatimit në të hyrat e korporatave. Përfundim do të kenë të hyrat nga interesi mbi kursimet të cilat nuk do të taksohen me synim të nxitjes së qytetarëve që të kursejnë sa më shumë nga të ardhurat e tyre. Synimi ynë është që përmes një norme të ulët të tatimit, të rritet interesimi i bizneseve që definitivisht të largohen nga ekonomia joformale. Një politikë e tillë premtion të hyra të qëndrueshme në afat të gjatë.
- Ligji për tatimet në korporata poashtu do të rishikohet dhe do të bëhen ndryshime në disa fusha. Kjo vlen për shpenzimet e lejueshme, për formën dhe shkallët e lejuara të amortizimit, për trajtimin e shpenzimeve për hulumtime dhe inovacione, donacionet për shkencë, kulturë dhe bamirësi, si dhe seksionet që merren me sanksionet për mospërbushje të obligimeve. Poashtu do të ndryshojmë shkallën standarde të tatimit në të hyrat e korporatave, në mënyrë që ky tatim të mos jetë barrierë për tërheqjen e investitorëve të huaj, që nënkupton harmonizim të saj me shkallët e aplikuara në vendet e rajonit. Kjo shkallë tatimore nuk do të jetë më e lartë se 10%. Shkallët e ulëta tatimore, baza e gjerë dhe e qëndrueshme si dhe shtrembërimet minimale për ekonominë do të shërbejnë edhe investitorëve të huaj si sinjal mbi seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit tonë tatimor. Tretman i veçantë do të ofrohet për mikrobizneset, sidomos për ato që pretendojnë të zgjerojnë aktivitetin e tyre përmes huamarrjes. Për zona të caktuara synojmë edhe ofrimin e pushimeve tatimore për periudha të caktuara, lokacione të caktuara, kondicione dhe sektorë të interesit të veçantë. Me një fjalë, ky tatim do të vihet në shërbim të politikave zhvillimore dhe atyre që synojnë reduktimin e divergjencave, në zhvillimin regjional të vendit.
- Në tatimin mbi vlerën e shtuar do të korigjohet ligjin ekzistues me synim të uljes së kostos së bashkëpunimit të bizneseve. Për prodhuesit që importojnë lëndën e parë do të mundësojmë përmbushjen e obligimit tatimor pas procesimit të lëndës së parë dhe finalizimit të ciklit të prodhimit. Kjo do të përmirësojë dukshëm rrjedhën e parasë së gatshme brenda bizneseve dhe do të lehtësojë dukshëm operimin e tyre.
- Do të fusim kontributet për sigurim shëndetësor dhe për mbështetje nga papunësia eventuale, por shkallët e kontributeve do t'i caktojmë në atë nivel që të mos ngritet

shumë kostoja e punës, andaj nuk do të rrezikohet aftësia konkurruese e bizneseve vendore.

- Do të ristrukturojmë komplet administratën tatimore të vendit në favor të depolitizimit dhe profesionalizimit duke futur konceptin e meritokracisë dhe duke implementuar sanksione të denja për inspektorë të korruptuar. Do të respektojmë fuqishëm tatimpaguesit e rregullt, dhe do t'i mbrojmë ata nga konkurrenca e pandershme e atyre që u ikin obligimeve tatimore. Për këtë qëllim do të krijojmë edhe policinë tatimore.
- Komunave do tu ofrojmë mundësi për më shumë të ardhura vetanake në mënyrë që të rrisim edhe përgjegjësinë e tyre ndaj elektoratit vendor. Në këtë drejtim do të gjejmë mundësi të reja për alokim të hyrave tatimore drejt buxheteve komunale. P.sh. transferi i të hyrave nga tatimi në të ardhurat e korporatave do të ndihmojë në rritjen e konkurrencës së njërive komunale në ofrimin e pakove kualitative të shërbimeve publike, për kompanitë e reja dhe ato ekzistuese.

Në fushën e shpenzimeve publike, alokimin e mjeteve buxhetore do ta bëjmë në bazë të prioriteteve që rezultojnë nga strategjia dhe vizioni ynë zhvillimor. Me paratë publike do të mbështesim vetëm përpjekjet për zhvillim ekonomik të vendit. Në programin e investimeve publike, suksesin tonë do ta masim me kualitetin e projekteve të aprovuara e jo me numrin e tyre.

Edukimin dhe shëndetësinë i trajtojmë si dy burimet themelore të akumulimit të kapitalit human dhe si një determinantë kyçe të produktivitetit të punës. Ky tretman do të reflektohet edhe në rishikimin e mjeteve të shpenzuara për këta dy sektorë, dhe Kosova nuk do të përmendet më si vendi që si % të GDP ka ndarë proporcionin më të vogël nga të gjitha vendet e rajonit.

Oferta e AKR-së në sferën e shpenzimeve buxhetore është ofertë për rritje ekonomike, efikasitet dhe shpërndarje më të drejtë të të ardhurës kombëtare. Në mandatin tonë, ne:

- Do të dalim me strategji complete të zhvillimit të vendit dhe ngritjes së mirëqenies së qytetarit. Kjo strategji pastaj do të konkretizohet përmes kornizave afatmesme të

shpenzimeve publike, kurse qeveria do të obligohet që gjatë hartimit të buxheteve vjetore të reflektojë në tërësi prioritetet e aprovuara në strategji zhvillimore dhe kornizën e shpenzimeve.

- Do të zvogëlojmë në minimum subvencionet e drejtpërdrejta për ndërmarrjet në pronësi publike. Deri më tani subvencionet e ndara e kanë shtyrë pa nevojë gatishmërinë e këtyre kompanive për të filluar ristrukturimin e mirëfilltë dhe operimin në bazë të principeve të ekonomisë së tregut.
- Shpenzimet publike do t'i orientojmë drejt mbështetjes së sektorëve me rëndësi primare siç janë edukimi dhe shëndetësia. Në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare do të sigurojmë mjete financiare shtesë, që do të shfrytëzohen për përmirësim thelbësor të infrastrukturës publike.
- Mjetet e parapara për investime publike do të orientohen edhe drejt atyre sektorëve që mundësojnë uljen e nivelit të papunësisë. Në ekonominë tonë, bujqësia kontribuon me një vlerë të konsiderueshme të shtuar përkundër vështirësive të vazhdueshme dhe mospërkrahjes institucionale. Ne garantojmë se do të gjejmë mekanizmat më të përshtatshëm për mbështetjen e fermerëve qoftë me qasje të volitshme në tregun financiar, me ngritje të kapaciteteve edukative apo edhe me mbështetje teknike. Përkujdesje e njejtë do të ofrohet edhe për sektorin e turizmit. Në këtë drejtim do të shtjerrim të gjitha mundësitë që edhe paratë e grumbulluara nga shitja e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore të vihen në funksion të gjenerimit të vendeve të punës.
- Si AKR, garantojmë se përkundër përpjekjeve tona për rritjen e mirëqenies së qytetarit, nuk do të lëmë anash ato kategori që kanë nevojë ose meritojnë një trajtim të veçantë shtetëror. Është fjala për kategorinë e atyre të cilët janë meritore për lirinë që gëzojmë ne sot, invalidët e luftës dhe familjet e dëshmorëve të luftës. Është obligim dhe vullnet i yni që këtyre kategorive tu ofrojmë përmirësim të vazhdueshëm të kualitetit të jetës. Poashtu do të kujdesemi që në tërë përpjekjet tona për avancim ekonomik të mos lejojmë grupe të caktuara të shoqërisë të mbeten mbrapa pa të ardhura të mjaftueshme për ekzistencë.
- Ju sigurojmë stabilitet afatgjatë të fondeve për sigurim pensional duke garantuar të gjithë kontribuesit se qeveria nën udhëheqjen tonë nuk do të lejojë në asnjë mënyrë keqpërdorim të fondeve të qytetarëve.

Në fushën e politikave monetare do të angazhohemi për fuqizimin substancial të Bankës sonë Qendrore. Banka qendrore do të ketë autonomi të plotë në ushtrimin e politikave të saja me synim të ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar të vendit. Këtë autonomi do ta shoqërojmë me rritje të llogaridhënies nga ana e menaxhmentit të bankës.

AKR dhe trajtimi i bujqësisë

Për AKR-në, bujqësia ka qenë, është dhe do të mbetet sektor i rëndësishëm së veçantë dhe sferë ku ka ende shumë hapësirë për rritje të produktivitetit dhe përparësi krahasuese me vendet e rajonit. Vizioni ynë është bujqësia me një rol më të madh në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit dhe në sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për fermerët tanë. Këtë AKR do ta arrijë përmes:

- Favorizimit të koncentrimit të sërishëm të pronave bujqësore me synim të rritjes së madhësisë mesatare të fermave,
- Ndërrimit të mënyrës së shfrytëzimit të tokave bujqësore duke favorizuar blegtorinë, pemëtarinë, vreshtarinë, shpeztarinë dhe bioproduktet në dëm të prodhimit tradicional të drithërave,
- Përmirësimit të kualitetit të tokës bujqësore përmes avancimit të sistemit të ujitjes,
- Zbutjes së barrierave financiare duke alokuar më shumë fonde për bujqësi dhe duke përmirësuar kushtet e huamarrjes për prodhues bujqësor,
- Ofritit të çmimeve të garantuara për prodhime bujqësore me synim të rritjes së insentivave të fermerëve për tu marrë me bujqësi si dhe të stabilizimit të të ardhurave të fermerëve duke i mbrojtur ata nga lëkundjet eventuale të çmimeve në treg,
- Gjetjes së mekanizmave më të përshtatshëm për mbrojtjen e prodhuesve bujqësor nga konkurrenca e pandershme e prodhuesve të subvencionuar nga rajoni, por pa vendosur barriera në qarkullimin e lirë të mallrave,
- Mbështetjes së procesimit të avancuar të prodhimeve bujqësore brenda vendit në mënyrë që vlera e shtuar e gjeneruar nga fuqia punëtore e Kosovës të rritet,

- Rritjes së aftësisë konkurruese të prodhuesve vendor përmes edukimit profesional. AKR do të hap fakultete dhe laboratore bujqësore në tri qendra të Kosovës. Me këtë edhe do të rrisim shanset e të rinjëve për të gjetur vende të punës. Përmes ngritjes së platformave të fuqishme agroekonomike do të mbështesim koncentrimin e prodhimit bujqësor dhe krijimin e vendeve të punës,
- Ngritjes dhe mbrojtjes së kualitetit dhe standardeve të prodhimeve bujqësore me çka do të përforcohej mbrojtja e konsumatorëve, do të rritej besueshmëria e konsumatorëve në prodhimet vendore dhe poashtu do të përmirësohej rejtingu në tregun ndërkombëtarë,
- Bashkëpunimit të ngushtë me shoqatat që përfaqësojnë interesat e fermerëve dhe mbështetja e hapave për koordinimin e aktiviteteve të tyre,
- Identifikimin dhe implementimin e fushave për zhvillim të turizmit agrar,
- Negocimit serioz të lehtësirave për plasman të prodhimeve kosovare në tregun e Bashkimit Evropian, sidomos në tregun e prodhimeve të mishit dhe bioprodukteve.

AKR poashtu premtan tretman kualitativ të industrisë së përpunimit të drurit. Të vetëdijshëm për potencialin e madh dhe traditën kosovare në industrinë e përpunimit të drurit, ne do të sigurojmë ambient të volitshëm për prodhuesit vendor duke garantuar në të njëjtën kohë baraspeshën ekologjike. Këtë do ta arrijmë përmes ripyllëzimit të pyjeve të vendit.

AKR dhe energjia

AKR në një afat gjashtë mujor do ta normalizoj problemin e furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike. Për të siguruar kapacitete adekuate të gjenerimit, ne do t'i rindërtojmë katër gjeneratorë nga A1 deri në A5 (420 MGW), të cilët do të lëshohen në punë në mënyrë suksesive (2009/2011). Do t'i rikonstruktojmë gjeneratorët e Kosovës B (2010/2012).

Do ta projektojmë termocentralin e ri prej 630 MGW, me gaz të kaltër (për t'u implementuar gjatë viteve 2012/2015). Po ashtu, AKR do t'i nxis dhe mbështes metodat

alternative të prodhimit të energjisë. Përmes ligjit do të kushtëzojmë që ndërtimet e ardhshme në Kosovë të jenë me zero kalori humbje.

Do ta arrijmë urgjentisht furnizimin e ekonomisë dhe të biznesit 100% me rrymë. Kosovën do ta furnizojmë me energji të lirë, nëpërmjet transferit, nga lindja e largët. Ne garantojmë modernizimin e rrjetit përçues dhe shpërndarës. Për katër vitet e para të qeverisjes do të investojmë në:

- Mënjanimin e humbjeve komerciale të teknike të energjisë elektrike
- Digjitalizimin i matësve elektrikë
- Kapacitetin e kufizuar të transferimit të energjisë elektrike përmes transformatorëve të trafostacioneve 220/110 kV
- Kapacitetin e kufizuar të transferimit të energjisë të rrjetit 110kV
- Avancimin e linjës interkonektive Kosovë-Shqipëri nga 220 kV në 400 kV.

Do të insistojmë që KEK-ku të menaxhohet nga profesionistë dhe nuk do të lejojmë politizimin e tij. KEK do të mbetet kryesisht pronë e shtetit të Kosovës dhe do të ketë aksionar privat. AKR do ta mbajë në pronësi publike sistemin e transmissioinit si garanci për funksionim të konkurrencës në segmentet e tjera të furnizimit me energji. Ne do të marrim hapa që Kosova urgjentisht të anëtarësohet në Kartën Evropiane Energjetike, Transmisionet Evropiane Energjetike dhe Protokollat përkatëse që lidhen me energjinë. Po ashtu, do ta krijojmë Agjencinë Kombëtare të Energjisë (AKE).

AKR për privatizimin dhe investimet e huaja

Ne do të mundësojmë investimet e huaja në vend, partneritetin me kompani vendore si dhe kalimin e pronësive në duart e investorëve që mund t'i kontribuojnë zhvillimit të vendit. E tëra kjo do të ndodhë duke iu falenderuar politikave dhe ambientit të volitshëm që AKR do të krijojë me vizionin ekonomik të saj.

AKR do të angazhohet që privatizimi të vazhdojë me një metode tjetër. Do ta hartojmë rregulloren e re që mundëson transferimin e asetëve vetëm tek ata që kanë një plan-program për zhvillimin e ndërmarrjes së privatizuar, si dhe do të bëjmë vlerësimin e ndërmarrjeve para se të privatizohen.

AKR do ta seleksionoj rajonin, ndërmarrjen dhe mënyrën si të privatizohet ndërmarrja duke pasur parasysh dobinë ekonomike që ja sjell ati rajoni, si dhe kohën më të volitshme për privatizimin e ndërmarrjes në radhë.

Do të angazhohemi që blerësi i ndërmarrjes të dëshmoj se është njohës i mirë i sektorit apo merret me veprimtari të ngjashme. Plani i biznesit do të jete pjese përbërse e ofertës së investitorit. Po ashtu do t'i monitorojmë zotimet e investitorëve. Transparenca e AKR-së për opinionin nuk do të mungoj.

Ne do të krijojmë “Agjencinë e Participimit” i cili do të jetë edhe pjesëmarrës në projekte strategjike në privatizim.

AKR angazhohet edhe për privatizim të ndërmarrjeve të caktuara siç është shitja e rrymës apo mbledhja e mbeturinave, natyrisht duke pasur gjithmonë parasysh krijimin e konkurrencës në vend. Po ashtu, ne garantojmë depolitizimin e bordeve të ndërmarrjeve publike.

AKR nuk është në favor të privatizimit të gjigantëve strategjikë siç është Trepça. Kosova ka burime të konsiderueshme natyrore dhe me një strategji të qëlluar të AKR-së, këtë potencial do ta shfrytëzojmë për zhvillim ekonomik të vendit ose do t'i konservojmë për një të ardhme. Po ashtu xhevahirët shtetëror të Kosovës siç është Brezovica do të jepen me koncesion 25 vjet e jo të privatizohen.

Për këtë arsye do ta mundësojmë urgjentisht implementimin e projektit për koncesione për eksploatimin e mineraleve, duke rezervuar gjithmonë kontrollin nga shteti i Kosovës

me aksion të artë dhe participim nga agjencia e participimeve nëse ato konsiderohen se do të jenë rentabile, nëse nuk janë rentabile ato do të konservohen.

AKR do të punojë në drejtim të tërheqjes së investimeve të huaja në Kosovë, të cilat do të sjellin një teknologji të re si dhe njohuri të menaxhimit të suksesshëm në lëmi të ndryshme, gjithmonë duke pasur parasysh rritjen e punësimit, prodhimit dhe plasmanit të produkteve në tregun ndërkombëtar.

Me qëllim të arritjes së këtyre synimeve, ne do të investojmë ne:

- Infrastrukturë,
- Sundimin e ligjit,
- Arsimimin e fuqisë punëtore
- Zgjerimin e tregut
- Furnizimin e rregullt me energji elektrike dhe ujë
- Marrëveshjet tregtare me vendet fqinje
- Kreditimin e bizneseve me norma të volitshme të interesit.

II. Departamenti i Punës dhe Shërbimeve Publike

AKR për krijimin e vendeve të punës dhe rrjetin e përkujdesjes sociale

AKR është shumë e vetëdijshme për rëndësinë që ka vendi i punës për mirëqenien dhe dinjitetin e secilit individ dhe secilës familje. Reduktimi domethënës i numrit të papunëve është prioriteti më i lartë i yni, prioritet ky në shërbim të të cilit do të vihen të gjitha politikatat, angazhimet dhe kapacitetet e Kosovës në përgjithësi dhe tonat në veçanti. Objektivat tona drejtohen në ofertën e punës, në kërkesën për punë dhe në vet mekanizimin e tregut të punës:

Në ofertën e punës do të ndikojmë si me politika aktive ashtu edhe pasive. Ndhimat për të papunë do t'i dizajnojmë në atë mënyrë që ato të ofrojnë mbrojtje të punëtorëve nga papunësia eventuale, por do e kufizojmë periudhën e beneficioneve në mënyrë që të mos shkatërrojmë interesimin e të papunëve për të kërkuar punë aktivisht. Në ato raste kur shanset për riaktivizim në tregun e punës janë minimale për shkak të moshës së shtyrë apo mungesës së kualifikimeve të kërkuara, do të shqyrtojmë edhe mekanizmat për pensionim të parakohshëm. Kjo do të na lehtësojë fokusimin në ata të papunë të cilët mund të rikualifikohen me sukses.

Sistemi i edukimit do të modifikohet në mënyrë që të ecë në harmoni me kërkesat e tregut dhe përshtatjet strukturore të ekonomisë. Do të punohet ngushtë me shoqatat e punëdhënësve të Kosovës, komunitetin joqeveritar dhe me agjencione e institucione ndërkombëtare si Banka Botërore, UNDP, ETF, ILO e të ngjashme me synim të rritjes së aftësisë së punëkërkuesve për të gjetur punë. Këto aktivitete sidomos do t'i drejtojmë në aftësimin profesional të të rinjve si në zonat urbane ashtu edhe rurale.

Angazhimi në përmirësimin e ofertës së punës nuk do të ishte komplet pa përmirësuar edhe kërkesën për punë. Me politikatat tona aktive do të mbështesim financiarisht bizneset që absorbojnë punëkërkues e sidomos për rastet e të papunëve afatgjatë. Ofrojmë mbështetje me kredi të volitshme për ata individë me ide që synojnë hapjen e bizneseve

të reja të vogla apo të mesme. Në fushën e infrastrukturës garantojmë vende të punës përmes projekteve të investimeve publike apo partneriteteve me sektorin privat.

Në vetë tregun e punës synojmë fuqizimin e zyrave për punësim në mënyrë që të shërbejnë si ndërmjetës të mirëfilltë mes ofertës dhe kërkesës për punë. Do të pajisim zyrat për punësim me baza të të dhënave ku punëdhënësit do të informoheshin vetë me vendet e hapura të punës, kurse punëdhënësve do t'i ofrohet qasje në informatat mbi disponueshmërinë dhe kualifikimet e punëkërkesve. Do të gjejmë mekanizma që e ngrisin mobilitetin e fuqisë punëtore brenda Kosovës.

Tregun e punës do ta liberalizojmë me çka do të ulim koston e punësimit për punëdhënës. Do të rishikojmë dhe kompletojmë legjislacionin primar dhe sekondar që rregullon funksionimin e tregut të punës, të drejtat dhe obligimet e punëdhënësve dhe punëmarrësve. Do të punojmë për futjen e kontratave të punës si mekanizëm standard i rregullimit të marrëdhënieve punëmarrës-punëdhënës.

Një segment tjetër me rëndësi të madhe për AKR-në është edhe gjetja e mundësive për lehtësim të përkohshëm të tregut të punës përmes aranzhimeve me ato vende që përballen me mungesë të fuqisë punëtore (Evropa perëndimore, Lindja e afërt).

Me ato vende që po shënojnë ritme negative të shtimit të popullatës do të gjejmë ato fusha ekonomike ku mungesa me fuqi punëtore do të plotësohet me punëkërkes kosovarë. Kjo do të lehtësojë buxhetin tonë duke zvogëluar shpenzimet për mbështetje të papunëve, do të gjenerojë të hyra për familjet e punëtorëve, të cilat pastaj do të nxisnin kërkesën për mallra vendore tek ne. Në afat të gjatë benefiti shtesë do të manifestohet në materializimin e shkathtësive të fituara në vendet e huaja dhe të kapitalit të akumuluar përmes investimeve në Kosovë të punëtorëve të kthyer.

Poashtu AKR do të dalë me ofertë serioze për diasporën tonë të bindur se do t'i bindim ata të investojnë punën dhe dijen e tyre në shërbim të ngritjes së mirëqenies së tyre dhe të zhvillimit ekonomik të vendit.

Me politikat tona ofrojmë ulje të shpejtë të normës së papunësisë duke lehtësuar kështu edhe buxhetin e vendit nga shpenzimet për mirëqenien shoqërore. Kjo do të na mundësojë që të rrisim mbështetjen për shtresat më të varfëra të shoqërisë dhe për ato kategori që nuk posedojnë me potencial për gjenerim vetanak të të ardhurave. Tretman të veçantë ofrojmë për familjet e invalidëve dhe dëshmorëve të luftës çlirimtare, të cilëve do tu ofrohet mbështetje në secilin aspekt, duke filluar nga të ardhura që mjaftojnë për një jetë me dinjitet, mbulim i shpenzimeve të edukimit të fëmijëve në të gjitha nivelet, mbulim i shpenzimeve për shëndetësi, dhe përfshirje aktive në masat për aftësim profesional.

AKR zotohet se nuk do të lejojë poshtërimin e mëtejshëm të pensionistëve të Kosovës. Ata do të gëzojnë vendin e tyre të merituar në shoqërinë kosovare. Sistemi i pensioneve bazë do të modifikohet në favor të diferencimit të atyre pensionistëve që kanë kontribuar rregullisht në fondin pensional. Fuqimisht do të insistojmë që mjetet e derdhura në këto fonde t'i kthehen kontribuesve.

AKR për shëndetësinë

AKR garanton një fillim dhe prezervim të shëndetshëm të jetës, sepse ruajtja e shëndetit dhe parandalimi i sëmundjeve do të jetë thelbi i sistemit shëndetsorë të Kosovës. Kjo do arrihet me metoda preventative, të miratuara nga departamenti i shëndetsisë në një kornizë të rregulluar me ligj, për të gjitha nivelet e shërbimeve shëndetësore. Kjo do të përfshijë edukimin e popullit duke shfrytëzuar përvojën e organizatave si Organizata Botërore për Shëndetësi, si për shembull promovimin për zvogëlimin e përdorimit pasiv të duhanit.

AKR garanton që strategjia e shëndetsisë në Kosovë do të bazohet në këto principe: profesionalizëm; kujdes të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë qytetarët e Kosovës, efikasitet, kosto-efektivitet, përshtatshmëri, kualitet të kujdesit, qëndrueshmëri, përgjegjësi, transparencë dhe disiplinë.

AKR do të adresojë nëninvestimin në shëndetësi duke alokuar një proporcion të buxhetit që përputhet me vendet në rajon dhe me normat e propozuara nga banka botërore për ekonominë në zhvillim. Deficitin e financimit do e regullojmë duke optimizuar shpërndarjen e fondit për shëndetsi, p.sh. do të adresohet deficitin për barna.

AKR do të investojë në ripërtirjen e infrastrukturës shëndetësore. Çdo departament shëndetësor i spitalit (apo shtëpi e mjekësisë familjare) do të furnizohet me pajisje të reja për të cilët do të jenë edhe përgjegjës. AKR do të eliminoj keqmenaxhimin e resurseve shëndetësore; duke krijuar zyre speciale që merren me monitorimin e cilësisë së mjekimit, monitorimin e shpërndarjes së barnave në spitale, monitorimin e pastërtisë, etj.

AKR garanton zvogëlim të mortalitetit (vdekshmërisë tek gjitha moshat) dhe të morbiditetit (proporcionin e njerëzve të sëmurë në krahasim me ata të shëndoshë). AKR synon të mbrojtë të rinjtë nga pasojat e neglizhencës. Ne do t'i shkollojmë të rinjtë për pasojat që manifestohen nga duhani, alkoholi, droga, shtatëzanitë e pa dëshiruara, sëmundjet që barten me kontakte seksuale, etj.

AKR do të mbështetë reformimin e menjëhershëm të studimeve mjekësore, duke investuar në hulumtimet shkencore të mjekësisë dhe duke promovuar bashkëpunimin me spitale universitare të vendeve tjera. Kjo do të ketë beneficion të shumëfishtë: forcimin e kapaciteteve të kuadrove për shërbime shëndetësore, promovimin e një kulture ku mjekësia ec në një hap me zbulimet më të reja botërore, kompensim të mëtejshëm për mjekët që i dedikojnë kohë hulumtimeve, zbatimin e teknologjive më bashkëkohore, etj.

Reformimi i studimeve mjekësore do mbështetë krijimin e institucioneve të shërbimeve që i mungojnë vendit, të cilat janë të domosdoshme për kompletimin e mbrojtjes shëndetësore të popullatës së Kosovës: Qendra Onkologjike; Reparti për Kirurgji Kardioinvazive; Qendra për Toksikologji; Qendra e Rehabilitimit nga përdorimi i drogave; Instituti për Farmakologji Klinike (për testimin e barnave vendore dhe të importuara, me qëllim të kontrollimit të barnave që janë në qarkullim).

Synimi i AKR-së është funksionimi i sistemit të integruar shëndetësor të Kosovës. Karakteristikat kryesore të sistemit të Kosovës do të bashkëpunojë ngushtë me sektorin privat për të arritur një shërbim më të plotë për popullin e saj. Integrimi i këtij sistemi është i paraparë të ofrojë tre nivele të shërbimeve mjekësore.

Kujdesi parësor (niveli komunal) do të përfshijë qendrat e mjekësisë familjare, njësitë e ndihmës emergjente, kujdesin shtëpiak, shërbimet e lehonisë para dhe pas lindjes (por jo edhe shërbimet e lindjes, të cilat do jenë pjese e spitaleve), barnatoret, dentistët, ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor, etj.

Kujdesi dytësor (niveli rajonal) do të përfshijë shërbimet spitalore dhe specialistike. AKR garanton ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dytësore që janë poliklinika specialistike, qendrat për shëndet mendor, qendrat rehabilituese, etj.

Kujdesi tretësor (qendra) do të përfshijë Qendrën Klinike Universitare (QKU); institucionet e ndryshme kombëtare siç janë ai i Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHP), i Transfuzionit të Gjakut, i Mjekësisë së Punës së Kosovës, i Mjekësisë Ligjore dhe i Psikiatrisë Forenzike.

Ne garantojmë që 70% të kujdesit mjekësorë të mbulohet në kujdesin parësor, 25% në kujdesin dytësor dhe vetëm 5% në atë tretësor.

AKR do të implementojë sistemin e sigurimit shëndetësorë i cili do të mbulojë gjithë popullatën e Kosovës. Sigurimi shëndetësorë mundëson shpërndarjen e rrezikut për shpenzime katastrofale, që do të arrihet përmes bashkëpunimit me spitale të vendeve tjera, ku do të ketë marrëveshje për shërbimet mjekësore dhe numrin e pacientëve për vit, d.m.th. do të përdoret ekonomia e shkallës.

AKR do të vendosë plafon për çmime të shërbimeve të ndryshëm që ofrohen nga mjekët në sektorin privat. Këto çmime do të suplementojnë sigurimin shëndetësorë dhe do të ndihmojnë në eliminimin e pagesave informale.

AKR e mbështet qeverisjen efikase të shëndetësisë nëpërmjet Departamentit të Shëndetësisë, e cila mban përgjegjësinë për krijimin e politikave shëndetësore. AKR do të përkrah shoqata apo institucione profesionale për mjek, dentist, farmacist dhe biokimist. Këto institucione do të kenë përgjegjësinë për një numër të faktorëve, duke përfshirë planifikimin strategjik, rregullativat mbi licencimin e klinikave private, mbylljen dhe hapjen e institucioneve shëndetësore, do të shqyrtojnë konfliktin e interesit për mjekët që punojnë në sektorin publik dhe atë privatë, promovimin dhe përkrahjen për specializime përkatëse, promovimin për shpenzime më efikase në barna (duke përkrahur ekonominë e Kosovës), etj.

AKR do të transformojë sistemin e kompensimit (dhe njëkohësisht ngritë pagat) për personelin shëndetësor. Personeli shëndetësorë që tregojnë punë të shkëlqyeshme do të ketë mundësi më të mëdha për përparim profesional. Ky lloj kompensimi do të eliminojë deformimin e moralit të nënpunësve shëndetësor dhe incidencën ekstenzive të pagesave informale dhe do të sigurojë shërbime të cilësisë së lartë për qytetarët.

AKR për infrastrukturën publike dhe shërbimet komunale

AKR garanton që infrastruktura e Kosovës do të modernizohet me standarde evropiane. Ne do të investojmë në të gjitha pjesët e Kosovës pa dallim në mes qyteteve dhe fshatrave. Me këtë përcaktim, AKR synon një ndërlidhje më të ngushtë në mes infrastrukturës dhe shërbimeve përkatëse komunale. Në veçanti AKR garanton punë në transportin rrugorë, telekomunikacion, aeroporte, hekurudha, menaxhimin e ujit, menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit, dhe investimet e modernizimit përkatëse në qytete dhe fshatra.

Transporti rrugorë

AKR trajton transportin rrugorë si arteriet e Kosovës, dhe qëllimi ynë është që këto arterie të jenë funksionale dhe të standardeve që e meriton një shtet evropian. Rrugët e Kosovës luajnë rolë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e saj ekonomik, dhe ne do t'i

kushtojmë një rol të veçantë, duke marrë parasysh vëllimin e mjeteve transportuese. Lidhjen rrugore me rrjetin evropian e konsiderojmë shumë të rëndësishëm, përkatësisht përshpejtimin e përfundimit së autostradës Merdare-Morinë, si dhe ndërtimin e autostradës Mitrovicë – Prizren.

Për AKR-në rrugët urbane dhe ndërubane kanë rëndësi shumë-dimensionale dhe ne do të investojmë në këto rrugë në mënyrë më transparente. Për shembull, kualiteti i ulët i rrugëve nga punuesit e sektorit privat do të rezultojë në përgjegjësi për neglizhencë për bizneset jo etike. Në veçanti, rëndësi luajnë ndriçimi adekuatë i rrugëve, semaforët, shenjat e komunikacionit, harmonizimi i rrugëve me ambientin hapësinorë, meremetimi apo ndërtimi i rrugëve që ndërlidhin fshatrat me qytetet, ndërtimin dhe materializimin e koncesioneve për veprimtaritë paralele rrugore (motelet, pompat e karburanteve, restoranteve dhe qendrave rekreative), etj.

Telekomunikacioni

AKR gjatë qeverisjes do të ndërtojë një infrastrukturë moderne në telekominukikim, jo vetëm në vendet urbane por edhe rurale. Qasja në internet dhe shërbimet tjera postale janë më se të nevojshme edhe në shkollat që gjenden në vendet rurale si dhe për popullatën që jeton në ato vende, komunikacioni me internet me botën e jashtme është më se i duhur. Brenda katër viteve të para të qeverisjes AKR do të realizon lidhjen e shumicës së shtëpive ne Kosovë me fibër që do të mundësojë shërbime të pa limituara të internetit.

AKR garanton përmirësimin e shërbimeve tjera postale në Kosovë, sidomos në adresimin korrekt dhe final të vendbanimeve me qëllim që posta të arrijë deri në destinacionin e saj. AKR po ashtu angazhohet për privatizim të pjesërishtëm të PTK-së dhe për një liberalizim më të madh të tregut.

Aeroporti

AKR në vitin e parë të qeverisjes do të riorganizoj strukturën e aeroportit, me objektiva që AP-ja të modernizohet duke përfshirë edhe infrastrukturën e nevojshme që të bëhet licencimi i aeroportit.

AKR synon rihapjen e aeroportit të Gjakovës si domosdoshmëri që Kosova të ketë edhe një aeroport të vogël që do të përdoret për fluturake sportive, nevoja bujqësore, edukative si dhe për nevoja urgjente.

Ne do t'i krijojmë kushtet gjat dy viteve të para të qeverisjes për të krijuar kushte për formimin e kompanisë së aviacionit të Evropës jug-lindore, e cila do të funksionoj me një model të aviacionit Skandinavez, duke përfshirë Kosovën, Shqipërin dhe Maqedonin. Aeroplanat e kompanisë do të jenë të alokuar në këto tri vende. Agjencia e participimeve do të jetë pjesëmarrëse në projekt.

Hekurudha

AKR do të hartojë ligjin mbi hekurudhat dhe menjëherë do të fillojë me rivitalizimin e rrjetit hekurudhor. Në katër vitet e para të qeverisjes do të bëjmë elektrifikimin e hekurudhave dhe vendosjen e të gjitha signaleve përcjellëse që të mund të kontrollohen nga qendra. Sidomos do të investojmë në linjën, veri-jug, që lidhin Kosovën me BE-në. Ne i japim prioritet shfrytëzimit hekurudhor për transportin e mallrave.

Menaxhimi i ujit

AKR do të rritë investimin në sistemin e ujit në proporcion me vendet në rajon dhe synon që në një afat të mesëm këto investime të nivelizohen me ato të bashkësisë evropiane. AKR do të përkrahë departamentin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë me obligimet e saj. Përkrahja do të jetë më e theksuar në mirëmbajtjen e gypave ujësjellës (eliminimin e humbjes), pastrimin e ujit të pijshëm, mirëmbajtjen dhe përgjegjësinë

përkatëse të ujësjellësve rajonal, efikasitetin e shpërndarjes së ujit në të gjitha pjesët e banuara, lidhjen e ujësjellësve me burime natyrore, projektimin dhe ndërtimin e tri digave për ujë, etj.

Menaxhimi i mbeturinave dhe ambientit

AKR nuk do të lejojë që edhe me tutje ambienti në Kosovë të degradohet. Ne do të aplikojmë standardizimin permanent dhe të vazhdueshëm me standardet evropiane për mirëmbajtjen e ambientit.

AKR do të merremtojë dhe ndërtojë infrastrukturën e kanalizimeve dhe mbledhjen e mbeturinave. AKR garanton krijimin e deponimeve bashkëkohore për mbeturinat urbane dhe do të krijoj kushtet për riciklimin dhe materializimin (me koncesionin) e tyre, sipas normave, në harmoni me ligjin për ruajtjen e ambientit dhe me qëllimin e rritjes së vlerës së shtuar.

AKR garanton që mirëmbajtja e menaxhimit të mbeturinave do të kontrollohet me parametra të lartë përgjegjësie duke marrë parasysh efektin direkt në shëndetin e popullit.

AKR garanton që do t'i ndërtojë parqet, lulishtet dhe parkingjet në çdo hapësirë ku do të jetë e mundur.

Qyteti

AKR garanton krijimin e kushteve për rregullimin e hyrjeve banesore, fasadave, instalimeve, shtigjeve, parkingjeve, parqeve, transportin e nxënësve, etj.

AKR garanton, aty ku është e mundur, për konservimin dhe legalizimin e të gjitha objekteve të ndërtuara më herët, e që nuk e kanë të kompletuar gjithë dokumentacionin për ndërtim (atyre që nuk e pengojnë rrugën dhe shtigjet lëvizëse publike, me kusht që pamja e jashtme të harmonizohet me kushtet urbanistike).

AKR garanton dhënien e lejeve të punës për objektet e reja banesore, të biznesit dhe ato publike, në kohë dhe kushte të caktuara, vetëm me kusht që të jetë i garantuar financimi që garanton parakushtin që infrastruktura edhe fasadat e jashtme të kryhen në kohën e caktuar dhe konform të planit hapësinor.

AKR garanton që shërbimet komunale do të jepen në koncesion (shërbimet publike për transport urban, planifikimi hapësinor, shërbimet higjienoteknike, etj.), me qëllim të rritjes së efikasitetit, transparencës dhe respektimit të afateve.

AKR u garanton shërbime qytetarëve (cilado qofshin ato) në kohë dhe cilësi të paraparë me ligj, vetëm nëpërmjet termineve të akorduara paraprakisht (SMS, e-mail, telefonatë, postë); me ç'rast qytetarit i mundësohet kryerja e shërbimeve shpejt dhe në mënyrë efektive, pa pritje dhe humbje kohe. Qytetari do të informohet për kushtet e kryerjes së shërbimit (sjelljen e dokumentit, taksat apo fletëpagesat) paraprakisht ose gjatë akordimit të takimit.

AKR garanton t'i transferoj burgjet, Universitetin e Prishtinës dhe administratën qendrore në periferi të qyteteve, duke garantuar ambiente të dinjitetshme, ku hapësirat e deritanishme do të shndërrohen në hapësira për qytetarin, biznesin dhe të parcelizuara me plan do të valorizohen dhe do t'i ofrohen komunitetit, duke gjeneruar para. Me këtë, qytetet do të lirohen nga ngulfatja e trafikut dhe objektet e panevojshme.

Fshati

AKR garanton krijimin e kushteve për objekte banesore, legalizimi i ndërtimeve pa leje, krijimin e kushteve për ngritjen e objekteve publike për tubime kulturore, humane dhe informative, ndërtimin e qendrave rekreative, transportin urban pa pagesë (pensionistët, invalidët etj.). AKR garanton krijimin e mundësisë për hapjen e veprimtarive ekonomike dhe integrimin e fshatrave në aktivitete ekonomike.

AKR për qeverisjen lokale

AKR e konsideron bartjen e pushtetit të qytetarit përmes delegimit të kompetencave dhe funksioneve nga qendra te njësitë më të vogla administrative, si parakusht për realizimin e demokracisë në kuptimin e saj të mirëfilltë, pra pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje.

Reformimi i suksesshëm i pushtetit lokal është ndër prioritetet kryesore të AKR-së dhe çfarëdo aktiviteti apo projekt i ndërmarrë në drejtim të realizimit të programit të AKR-së, do të trajtohet edhe nga aspekti i përshtatshmërisë së tij në dimensionin e qeverisjes lokale

Ne garantojmë që reformat në pushtetin lokal do të jenë gjithëpërfshirëse dhe veprime për përmirësimin e pozitës së të gjithë qytetarëve, pasi dëshirojmë që pikërisht përmes fuqizimit të qytetarëve të rritim përgjegjësinë, transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë tek qytetarët për veprimet e saj.

AKR i konsideron qytetarët bartës kryesor të procesit të përmirësimit të administrimit të pushtetit lokal, dhe ndërtimi i besimit qytetar-pushtet lokal është ndër sfidat kryesore. Ne do të bëjmë përfshirjen e gjerë të popullatës në procesin e vetëqeverisjes dhe identifikimit të nevojave të tyre, me qëllim të hartimit të politikave zhvillimore sa më të përshtatshme për vet ata.

AKR nuk e sheh reformimin e pushtetit lokal si rrugë e vetme për përmirësimin e pozitës së pakicave, por pikërisht përmes krijimit të kushteve për vetëqeverisje dhe kthimit të dinjitetit për të gjitha komunitetet, ne shohim strategjinë kryesore për inkuadrimin e të gjithëve në jetën publike të Kosovës, duke e konsideruar veten si pjesë të saj.

Qytetarët e Kosovës meritojnë një standard më të mirë të jetës nëpër njësitë komunale ku ata jetojnë, dhe AKR do të ndërmerr një varg aktivitete në përmirësimin e shërbimeve publike dhe administrative të drejtuara qytetarëve.

AKR mbështet reformimin e administratës dhe ofrimin më cilësor të shërbimeve për qytetarët. Ne, krahas rritjes së kualitetit dhe cilësisë në ofrimin e shërbimeve, do të bëjmë rishikimin e numrit të personelit të punësuar në administratë, duke e nivelizuar numrin i tyre në favor të efikasitetit.

Kuadri i shërbyesve civil do të angazhohet vetëm në baza meritore dhe do të eliminohet punësimi në baza politike ose nepotizmit. Për vet shërbyesit, do të krijohet një plan për promovimin e tyre në bazë të rezultateve të shfaqura dhe do të ofrohen trajnime ose shpërblime për punëtorët më të mirë.

Ne, rëndësi të veçantë i kushtojmë rritjes së transparencës në punën e autoriteteve lokale dhe konsultimit e informimit të vazhdueshëm me qytetarët, që do ta bëjmë duke organizuar takime të rregullta, forume dhe debate të ndryshme me qytetarët.

Ne u garantojmë qytetarëve të Kosovës, se niveli i kompetencave që do të delegohet nëpër njësi lokale do të jetë i njëjtë për të gjitha komunat dhe nuk do të bëhen dallime në këtë drejtim pa marrë parasysh përbërjen etnike të komunave.

AKR siguron që fillimisht do të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme për një ndarje të qartë të kompetencave mes nivelit të pushtetit qendror dhe atij lokal, ku në veçanti do të shmangen konfliktet mbi shkallën e autorizimeve si në vijë vertikale, pra mes pushtetit qendror dhe atij të deleguar, ashtu edhe në vijën horizontale, pra mes vetë njërive të pushtetit lokal.

Për të funksionalizuar reformën e pushtetit lokal, AKR do të prioritetizoj plotësimin e kornizës ligjore në vend për rregullimin e kësaj sfere, duke përfshirë nxjerrjen e legjislacionit primar dhe sekondar, me të cilën do të përcaktoheshin bazat e funksionimit efektiv të qeverisjes lokale.

AKR premtan se para planifikimit të çfarëdo strategjie për njësitë lokale, do të bëjë vlerësim gjithëpërfshirës të gjendjes në terren dhe pas konsultimit me qytetarët së bashku

do ti përcaktojnë prioritetet për atë komunë dhe ky do të jetë proces mirë i planifikuar, analizuar dhe i mbështetur në burime dhe kapacitete reale institucionale dhe njerëzore.

Spektori privat sipas AKR-së ka një rol themelor në zhvillimin e qeverisjes lokale, sidomos përmes kontraktimit të ofrimit të shërbimeve elementare për qytetarët, gjë që siguron edhe shërbime më efikase. Kjo nënkupton se qytetarët do të kenë kontakt minimal të drejtpërdrejtë me administratën gjë që edhe eliminon korrupsionin në këtë sektor. Nxitja e një konkurrence brenda vet këtij sektori do të siguroj edhe zhvillim ekonomik lokal dhe do të nxisë investime më të mëdha në këtë drejtim.

AKR parasheh krijimin e një strategjie për gjenerimin e mjeteve shitesë nëpër komuna për sigurimin e një qëndrueshmërie financiare të tyre dhe e përkrahim menaxhimin e të hyrave lokale nga vet komunitat, me qëllim të orientimit të tyre drejt prioritetëve të përcaktuara nga ata.

Në kuadër të secilës njësi komunale, rëndësi të veçantë do ti kushtohet planifikimit dhe shfrytëzimit sa më i mirë dhe racional të vendeve publike, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira qytetarëve. Prioritet në rregullimin e tyre kanë: rrugët, parkingjet, vendkalimet për këmbësorë, përshtatja e infrastrukturës për persona me aftësi të kufizuara, trotualet, parqet, varrezat, parqet/sheshet e lojërave, fushat sportive, monumentet kulturore ose historike, WC-të publike, menaxhimi i mbeturinave, etj

Furnizimi i rregullt i qytetarëve me ujë, shfrytëzimi me kujdes dhe rruajtja e ujit nga keqpërdoruesit së bashku me mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, është ajo çka premtion AKR për të siguruar një të ardhme më të mirë për qytetarët e Kosovës.

AKR premtion kthimin e plotë të menaxhimit të pronave tek komunitat, për të siguruar planifikim dhe shfrytëzim sa më të mirë të saj, ku do të përcaktohen edhe kushtet e qarta për dhënien e lejeve të ndërtimit, duke mbrojtur gjithnjë interesat e qytetarëve.

Prishtina, si njësi komunale do të ketë organizm të veçantë, gjë që do të rregullohet me ligj të posaçëm, me të cilin do të parashihet që të ndahet në disa regjione dhe zona të caktuara me qëllim të sigurimit të efikasitetit në ofrimin e shërbimeve për qytetarë dhe lehtësimin e qasjes së tyre në organet e administratës lokale. Secili regjion/zonë do të ketë zyrat e veta administrative për ndërlidhje me qytetarë, të cilat do të kujdesen për shpejtimin e ofrimit të ndihmës dhe dhënien e përgjigjeve ndaj kërkesave të tyre. Duke dashur të thjeshtësohet jeta e qytetarit të Prishtinës, ne do të bëjmë riemërtimin e rrugëve të qytetit, që do të mbështetet në enumeracion dhe baza regjionale, gjë që do të siguroj qëndrueshmëri dhe lehtësim për të gjithë.

III. Departamenti i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit

AKR për arsimin

Kosova posedon ndër pasuritë më të çmuara në botë – rininë dhe përkushtimi për ofrimin e mundësive më të mira për edukim dhe perspektivë në karrierë, garanton ta shndërrojë atë në energji pozitive dhe zhvilluese për vendin tonë. AKR konsideron edukimin si ndër sektorët me prioritet parësor, prandaj edhe vizioni i AKR-së për shoqërinë kosovare është ta shndërroj atë në SHOQËRI TË BAZUAR NË DIJE.

AKR e konsideron edukimin në Kosovë si: faktor të stabiliteti shoqëror dhe avancimit të demokracisë; proces të ngritjes së përgjegjësisë tek qytetarët; proces për përmirësimin e standardit dhe kualitetit të jetës; parakusht direkt për zhvillimin ekonomik dhe zvogëlimin e varfërisë; mundësi për parandalimin e punës në të zezë; parandalim të shfrytëzimit të fëmijëve si fuqi punëtore; parandalim të trafikimit; mundësi për përmirësimin e shëndetit dhe parandalimit të shpërndarjes së sëmundjeve ngjitëse; mënyrë për vetëdijesimin e qytetarëve për kujdesin ndaj mjedisit dhe natyrës, etj.

Sipas AKR-së, ndër parakushtet kryesore për ndërtimin e një sistemi të mirëfilltë të edukimit është harmonizimi i planeve dhe veprimeve në nivelet e ndryshme të arsimit, duke koordinuar veprimtaritë në të gjitha nivelet që do të garantonte konsistencë në cilësi të edukimit. Ne përkrahim një decentralizim më të madh në arsim dhe rritjen e autonomisë së këtyre institucioneve, por gjithnjë duke ndërtuar mekanizma për mbikëqyrjen dhe kontrollin e autonomisë.

Niveli parashkollor – “Super fillimi”- Që fëmijët tanë të kenë fillimin më të mirë të mundshëm në edukim, duhet përkrahur zhvillimin e tyre qysh nga niveli parashkollor. AKR përkrah përmirësimin e cilësisë dhe infrastrukturës bazë të këtyre institucioneve dhe ndër tjera do të bëjë: ndërtimin dhe hapjen e institucioneve parashkollore në numër të mjaftueshëm,; rritjen e numrit të fëmijëve në programe parashkollore; vijimin e obligueshëm që nga mosha 3 vjeçare për të ndikuar në socializmin e tyre; përcaktimin e

rregullave të qarta për licencimin e institucioneve parashkollore private; shtimin e kuadrove të kualifikuara për të punuar në këto institucione; si dhe inspektimin e vazhdueshëm të punës së institucioneve publike dhe private parashkollore.

Ne angazhohemi gjithashtu edhe për përmirësimin e vet programit që duhet zhvilluar në këto institucione dhe parashohim: mësimin e hershëm dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit maksimal ndaj fëmijëve; fillimin e mësimin të hershëm të gjuhëve të huaja; programin e pasur sportiv dhe kulturor; si dhe kujdesin e posaçëm ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Ne garantojmë depolitizimin absolut të sistemit të edukimit në të gjitha nivelet në Kosovë, duke përkrahur dhe mbështetur vlerat profesionale dhe duke siguruar zbatimin e plotë të etikës profesionale nëpër institucionet e arsimit.

Niveli i arsimit fillor – “Gjithëpërfshirje-mundësi e barabartë”

AKR me gjithëpërfshirjen e fëmijëve në nivelin e arsimit fillor nënkupton ofrimin e mundësisë së barabartë të shkollimit për të gjithë fëmijët e Kosovës pa marrë parasysh dallimet, qoftë sociale, etnike apo vendet ku ata jetojnë.

AKR premtan se jo vetëm që do të sjell të gjithë fëmijët në shkollë, por do t’ua ndërtoj dhe sjellë shkollat fëmijëve edhe në viset më rurale. Ne do të punojmë drejt plotësimit dhe përmirësimit të infrastrukturës së shkollave fillore dhe përmirësimit të cilësisë dhe kualitetit të mësimin, me qëllim të rritjes së suksesit tek fëmijët.

Ne do të bëjmë rishikimin e gjitha planprogrameve të reja duke ia përshtatur nevojave aktuale të Kosovës dhe fëmijëve tanë dhe sidomos do të bëhet rishikimi dhe reformimi i planprogrameve të kontestuara nga ekspertë të ndryshëm.

AKR garanton zvogëlimin e numri të nxënësve nëpër klasa deri në 25 persona, duke krijuar hapësirë të mjaftueshme për secilin nxënës dhe gjithashtu do të ofroj programin e

mësimin në shtëpi ose spital për fëmijë të cilët për shkaqe shëndetësore nuk mund të jenë të pranishëm në shkollë, edhe pse janë të regjistruar.

AKR do të punon drejt integritit të fëmijëve “viktima” të mërgimit në shkollë, si dhe do të shkolloj, edukoj dhe mbështet fëmijët e rrugës dhe familjet e tyre, meqë rast do të realizohet eliminimi i plotë i punës së fëmijëve në Kosovë. Për këtë proces është e domosdoshme edhe ndihma e profesionistëve, prandaj ne do të rikthejmë pedagogët dhe psikologët nëpër shkollë.

Do të sigurohet realizimi i ligjit ekzistues për sigurimin e librave shkollor dhe uniformave për të gjithë fëmijët, kurse për të ngritur vetëdijen e fëmijëve për të drejtat e tyre do të krijohet një program i veçantë, ashtu sikurse edhe për mësimin e gjuhëve të huaja, duke e shndërruar atë në argëtim.

Niveli i arsimit të mesëm – “E ardhme për të gjithë”

Ndër objektivat kryesore të AKR-së në sferën e edukimit është që arsimi i mesëm (nga moshë 15 -18 vjeçare) të shndërrohet në edukim të obligueshëm. Në anën tjetër, AKR merr obligim edhe përmirësimin e jetës kulturore dhe shoqërore, meqë rast do të ndërtoj infrastrukturë përkrahëse si, qendra kulturore, rinore, rekreative-sportive, etj.

AKR do t’i furnizojë me kompjuterë të gjitha shkollat e mesme dhe do të siguroj qasje në internet, me qëllim të aftësisë të nxënësve nga të gjitha viset e Kosovës për shfrytëzimin e kompjuterëve dhe burimeve të nevojshme për ata.

Do të krijohen programe për drejtime të ndryshme profesionale, duke iu përshtatur nevojave të tregut të punës, si dhe programe të veçanta për zanate të specializuara në viset rurale, me qëllim të përgatitjes së të rinjve për tu bërë bartës të zhvillimeve në ato vise si dhe parandalimin e zhvendosjes së tyre nëpër qendra tjera;

AKR premtan bursa për nxënës të shkëlqyeshëm, me qëllim të nxitjes së përmirësimit të kualitetit të përgjithshëm dhe krijimin e një programi të posaçëm për identifikimin, vëzhgimin, përcjelljen dhe përkrahjen e nxënësve të talentuar , për ti ndihmuar Kosovës.

Për të ndihmuar dhe orientuar të rinjtë në vendosje për karrierën e tyre, do të krijohen zyra për zhvillimin e karrierës dhe;

Gjithashtu, AKR siguron lehtësimeve të ndryshme për nxënës në shërbimet publike si mjete të transportit publik, buleta dhe sfera tjera;

Niveli i arsimit të lartë – “Pjesë e botës”

AKR do të trajtoj dy çështjet kryesore në kuadër të arsimit të lartë që sigurojnë funksionim më të mirë të tij, e këto janë përmirësimi i gjendjes së rëndë në Universitetin e Prishtinës dhe çështja e arsimit të lartë privat. Prioritet në këtë drejtim është sigurimi i kualitetit dhe cilësisë në mësim si dhe kontrollimi i numrit të universiteteve private që funksionojnë, përmes funksionalizimit të Agjencisë për Akreditim dhe Kontroll të Kualitetit e Cilësisë në arsimin e lartë.

AKR do të ndërmarrë një varg masash dhe veprimesh për stabilizimin dhe krijimin e qëndrueshmërisë në arsim të lartë, si përmes përmirësimit të infrastrukturës, kushteve për mësimdhënës dhe kushteve për student.

Ne mbështesim dhënien e një autonomisë financiare më të madhe për universitetin publik të Prishtinës dhe njësisive akademike, si mekanizëm për sigurimin e vet-qëndrueshmërisë dhe orientimit të mjeteve në drejtim të konkurrencës me institucionet private.

AKR, fillimisht do ta bëjë vlerësimin e hollësishëm të gjendjes së arsimit të lartë në Kosovë, me qëllim të identifikimit të nevojave dhe përcaktimit të politikave për zhvillimin e një strategjie për riorganizimin e universitetit, duke e ndarë atë në disa qendra universitare të vogla nëpër regjione të ndryshme të Kosovës, varësisht prej afiniteteve dhe traditës që ekziston në këto qendra.

Do të formohen katedra të studimeve nëpër qendra të ndryshme të Kosovës, me qëllim të përkrahjes së traditës së deritanishme dhe avantazheve që ofrojnë këto vende: në Ferizaj do të vendoset Shkolla e Lartë e Turizmit dhe Gastronomisë; në Gjiilan – Katedra i Bujqësisë; në Prizren – Katedra e Etnokulturës dhe Artizanatit; në Gjakovë – Katedra e Pedagogjisë dhe Mësuesisë; në Pejë – Katedra e Arteve të Bukura (ku do të hapet edhe muzeu i arteve të piktorit Ibrahim Kodra) dhe në Mitrovicë – Katedra e Diplomacisë.

Ne do të punojmë drejt përmirësimit të kualitetit dhe cilësisë së mësimdhënies, duke zbatuar në mënyrë të mirëfilltë Deklaratën e Bolonjës dhe promovojmë përfshirjen maksimale të mësimit interaktiv për studentë dhe komponentit të praktikës, hulumtimit dhe kreativitetit.

AKR do t'i kushtoj rëndësi të veçantë punës shkencore dhe profesionale në arsimin e lartë dhe do të përqendrohet në themelimin dhe riaktivizimin e instituteve për hulumtim dhe zhvillim brenda universiteteve, që njëkohësisht do ndikoj edhe në shtimin e kuadrit mësimdhënës dhe përgatitjen e tyre profesionale. Gjithsesi, AKR këtë e sheh edhe si rrugë për përmirësimin e pozitës materiale për mësimdhënës duke i angazhuar në projekte të ndryshme si kontraktorë të qeverisë.

AKR garanton qasje për profesionistë nga Kosova në tregun e punës dhe konkurrencës në Evropë dhe do të krijoj programe për “kthimin e trurit” nga jashtë, duke u krijuar kushte banimi dhe pune në Kosovë. Për këto arsye, AKR do të siguroj lehtësimin dhe shpejtimin e procesit të nostrifikimit të diplomave të fituara jashtë vendit.

Ne garantojmë vendosjen e kritereve dhe kushteve të qarta për lëshimin dhe kontrollimin e licencave për universitetet private dhe do të parandalojmë komercializimin e edukimit universitar në Kosovë. Për këtë arsye, ne do të bëjmë rishikimin e të gjitha licencave të lëshuara deri më tani,

Duke i përcjell trendet e zhvillimeve të reja globale, ne njohim nevojën për edukim konstant, prandaj krijimi i një programi të mësimi të vazhdueshëm është prioritet për ofrimin e mundësisë për edukim të përhershëm dhe në pajtim me kërkesat e kohës;

AKR përkrah vendosjen e partneriteteve të reja me universitete jashtë Kosovës dhe thellimin e atyre ekzistuese, duke premtuar sigurimin e fondeve të veçanta për funksionalizmin e tyre dhe përmes krijimit të një fondi të veçantë për përkrahje të stafit mësimdhënës për pjesëmarrje në konferenca, simpoziume dhe seminare shkencore.

Ne do të furnizojmë me kompjuterë të gjitha institucionet e larta të arsimit, duke mundësuar kyçjen wireless në gjithë qytetin e studentëve dhe ndërtesat e universitetit, si dhe do të mundësojmë abonimin në revista të ndryshme shkencore dhe hulumtuese për t'i mbajtur të informuar të gjithë të interesuarit me të arriturat e reja në shkencën bashkëkohore.

Për përmirësimin e kushteve të studentëve, AKR do ndërmarr një varg projektesh të gjera të cilat përqendrohen në ofrimin e kushteve më të mira për studime dhe stimulimin e tyre për rezultate të suksesshme. Ofrimi i bursave për studentë të shkëlqyeshëm dhe nxitja e tyre të shkojnë në studime në degët deficitare, janë prioritet të AKR-së. Gjithashtu, një fond i veçantë do të krijohet për përkrahjen e studentëve për shkollim jashtë vendi, me qëllim të kthimit të tyre si kuadro të përgatitur për përballimin e nevojave të vendit.

AKR konsideron punën praktike gjatë studimeve, sidomos gjatë verës si element kyç për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve dhe përgatitjes së tyre profesionale. Për këtë qëllim, AKR do të përkrah krijimin e zyrave për zhvillim të karrierës në universitete për ti ndihmuar studentët në orientimin e tyre profesional.

AKR gjithashtu do të nxisë studentët të kyçen në aktivitete bamirëse duke ofruar shërbime vullnetare për pleq, fëmijë dhe të sëmurë, të cilat njëkohësisht e rritin përgjegjësinë e tyre si qytetarë.

Studentëve, AKR ju garanton lehtësime të ndryshme, si në shfrytëzimin e mjeteve të transportit publik, buletave për aktivitete kulturore, mundësi për kredi studentore me kushte të volitshme, hapësira të mjaftueshme dhe dinjitoze për banim, etj.

AKR do të krijoj fond të veçantë për projekte të studentëve të cilat kanë qëllim avancimin e dijes dhe njohurive dhe përmirësimin e përgjithshëm të pozitës së tyre dhe ndër tjera do të ndërtohen qendra për aktivitete sportive, kulturore dhe shoqërore.

AKR për kulturën

AKR konsideron se njëra ndër mënyrat kryesore për kthimin e dinjitetit të qytetarëve të Kosovës është pikërisht përmes përkushtimit dhe investimit në kulturë dhe vlerat e saj. Prandaj, ne pranojmë dhe do të punojmë rrymimin e kulturës në mbarë Kosovën dhe premtojmë që artistëve dhe artdashësve do tu krijohen kushte normale për ushtrimin e veprimtarive të tyre.

AKR, garanton një buxhet vjetor dinjitoz për kulturën Kosovare, përmes të cilit do të përkrahen projekte me vlerë kombëtare dhe nacionale për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ne sigurojmë krijimin fillestar të kushteve të volitshme për kulturën kosovare, ashtu që brenda një kohe relativisht të shkurtër të jetë në gjendje të gjeneroj mjete të mjaftueshme për të siguruar vet-qëndrueshmëri dhe zhvillim të mëtejshëm.

Ne përkrahim dhe garantojmë shtrirjen e aktiviteteve kulturore në të gjitha regjionet e Kosovës, me qëllim të mundësimin të pjesëmarrjes së gjerë të gjithë qytetarëve në këto aktivitete të rëndësishme për një jetë normale shoqërore.

AKR premtim investime në infrastrukturën e kulturës kosovare, duke krijuar kapacitete fizike të mjaftueshme për zhvillim të aktiviteteve dhe do të fokusohet në ndërtimi e një muzeu kulturologjik në Prizren, themelimin e Institutit Kombëtar Kulturologjik, jetësimin e projektit të mirëfilltë të Teatrit të Operës dhe Baletit në Prishtinë, rivitalizmin e laboratorit të produksionit filmik, renovimin dhe ndërtimin e kinemave nëpër të gjitha

qendrat, renovimin e Teatrit Kombëtar, ndërtimin e muzeut të arteve “Ibrahim Kodra” në Pejë, etj.

Ne gjithashtu do të ndërtojmë një qendër inter-religjioze, e cila do të mirëpres të gjithë personat që u takojnë religjioneve të ndryshme dhe ka për qëllim afrimin dhe vendosjen e marrëdhënieve miqësore mes tyre.

AKR do të punon në ndërtimin e kapaciteteve njerëzore zhvilluese dhe të menaxhuese për kulturën dhe njëherazi premtan ringjalljen dhe krijimin e institucioneve të domosdoshme për bartjen e detyrave zhvillimore të kulturës.

Ndër prioritetet e AKR-së në fushën e kulturës është ndërprerja e izolimit të saj ndaj botës dhe krijimi i mundësive për promovimin e vlerave të kulturës kosovare në mbarë botën. Kjo do të bëhet përmes ndarjes së një fondi të veçantë për përkrahjen e pjesëmarrjes së artistëve vendorë në aktivitete ndërkombëtare që i sjellin Kosovës promovim dhe inkuadrim në rrjedhat e kulturës botërore.

Rëndësi e veçantë do ti kushtohet talenteve të rinj të artit të cilët do të përkrahen për zhvillimin e mëtutjeshëm si brenda, ashtu edhe jashtë vendit, duke i mundësuar njëkohësisht arenës ndërkombëtare njohjen me kulturën kosovare.

Me qëllim të sigurimit të vlerave krijuese të artistëve vendorë, ne do të funksionalizojmë dhe plotësojmë legjislacionin e brendshëm për mbrojtjen e të drejtave autoriale dhe pronën intelektuale. Njëherazi, AKR premtan luftimin e piraterisë si dukuri dëmtuese për ekonominë e vendit dhe zbatimit të normave të pranueshme ndërkombëtare në këtë fushë.

AKR mbështet zhvillimin dhe përhapjen e vlerave kulturore të të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijimi i një programi të posaçëm për afrim të komuniteteve përmes kulturës është njëra ndër prioritetet tona në fushën e kulturës.

Përkushtim të posaçëm ne i japim programeve kulturore në radio televizionin publik dhe ato lokale, duke siguruar fonde për zhvillimin e emisioneve kulturore që kanë për qëllim promovimin e vlerave të caktuara dhe sidomos atyre të orientuara për fëmijët dhe rininë.

Trashëgimia kulturore është e një rëndësie kombëtare dhe do të kushtohet kujdes i veçantë, ku do të bëhen investime të gjëra, duke tërhequr njëkohësisht edhe fonde ndërkombëtare për promovimin dhe ruajtjen e saj. Mbrojtja e monumenteve kulturore-historike dhe fetare, si dhe stimulimi i kërkimeve arkeologjike dhe ekspozimi i tyre në Muzeun e Kosovës dhe në muzetë rajonale të Kosovës janë kyçe për AKR-në.

AKR për rininë

AKR konsideron se fuqizimi i rinisë dhe krijimi i një bashkëpunimi të gjerë dhe të mirëfilltë mes qeverisë dhe organizatave rinore për adresimin adekuat të nevojave të të rinjve në Kosovë është sukses i garantuar për një të ardhme më të mirë për gjithë Kosovën. .

AKR garanton se do të përqendrohet në katër pika strategjike që janë thelbësor për jetën e të rinjve: sigurinë, shëndetin, kohën e lirë dhe ambientin e përshtatshëm, si dhe edukimin dhe trajnimin. Kjo strategji do të ndikoj në zvogëlimin e krimit tek të rinjtë, eliminimin e frikës së të rinjve nga krimi dhe ndihmesën e të rinjve që janë viktimat e krimit.

Gjithashtu, ne përkrahim zhvillimin e projekteve që kanë për qëllim fushatat që luftojnë dukuritë negative, si duhani, narkomania, alkooli, si dhe njoftimin rreth sëmundjeve ngjithëse si AIDS që përmirësojnë shëndetin e rinisë, si dhe projekte për vetëdijesimin e të rinjve për problemet me mjedisin dhe mbrojtjen e tij.

Një fond për përkrahjen e rinisë kosovare në përfshirjen e aktiviteteve ndërkombëtare që kanë qëllim afrimin e tyre dhe vendosjen e lidhjeve miqësore është ndër format përmes së cilave AKR do të mbështes rritjen e vetëdijesimit të rinisë për rolin e tyre.

Ne garantojmë ndërtimin e një parku të madh për argëtim për të rinjtë, i cili do të përfshijë të gjitha format e argëtimit dhe zbavitjes rekreative, kulturore dhe sportive, duke pasur për qëllim tërheqjen e të rinjve nga i gjithë rajoni i Evropës jug-lindore, promovimin e Kosovës dhe mundësimin e rinisë tonë të krijoj lidhje miqësie me të rinjtë nga e gjitha bota.

AKR posaçërisht do të mbështes projekte të rinisë për përmirësimin e komunikimit në mes të rinjve nga komunitetet e ndryshme të Kosovës dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe sportive, kampingjeve apo mundësimin e debateve të ndërsjella.

Ne sigurojmë përkrahjen e projekteve për promovimin e demokracisë, vlerave të saj dhe rolit të rinisë në këtë proces, e sidomos zhvillimit të fushatave për vetëdijësimin e tyre për rolin e përfshirjes në procesin e vetëqeverisjes dhe vendimmarrjes. Për këtë arsye, ne do të krijojmë qendra për informim dhe konsultim të të rinjve në të gjithë Kosovën.

Krijimi i një ambienti të përshtatshëm nëpër gjithë rajonin e Kosovës për tu mundësuar të rinjve angazhime të ndryshme me qëllim të nxitjes së kreativitetit dhe talenteve të tyre, është garanci që ofron AKR për rininë.

AKR do të bëjë rregullimin e fushave sportive nëpër vendbanime dhe lagje përgjatë Kosovës, duke ofruar kushte dhe mundësi të barabarta për të gjithë dhe njëherazi do të nxisë projekte që synojnë zhvillimin e aktiviteteve garuese dhe edukative për të rinjtë.

AKR siguron përfshirjen e sektorit privat në implementimin e projekteve që synojnë përmirësimin e kushteve për rininë, duke u ofruar atyre lehtësime të ndryshme varësisht prej angazhimit dhe kontributit në përfshirjen dhe përfitimet e rinisë nga bizneset private.

AKR për sportin

AKR e konsideron sportin si mekanizëm për shërimin e shoqërisë dhe bashkimin e botës, krijimin e shpresës kur aty ka zhgënjim, thyes të barrierave, tejkalim për çfarëdo lloj diskriminimi dhe si gjuhë unike të cilën e kupton e gjithë bota..

Përmes inkurajimit të sportit, AKR do ti mundësoj rinisë përfshirjen në aktivitete të shumta ku ata mësojnë aftësi dhe vlera shumë të rëndësishme për të bashkëpunuar me tjerët, luajtur drejt, për të fituar, humbur dhe ndihmuar të tjerët në jetë.

AKR siguron që sportit dhe aktiviteteve të tij do ti ndahen mjete të mjaftueshme për zhvillimin e rregullt të aktiviteteve të tij, duke e përkrahur njëkohësisht ndërtimin e kapacitetet gjeneruese që pas një periudhe kohore do ti sigurojnë qëndrueshmëri dhe vetëfinancim.

AKR konsideron se njëra ndër rrugët kryesore të promovimit të Kosovës në sferën ndërkombëtare është përmes sportit dhe talenteve në këtë fushë që i posedon Kosova. Prandaj, ne premtojmë ndërtimin dhe zbatimin e një strategjie të detajuar për zhvillimin e sportit kosovar dhe promovimin e tij jashtë kufijve shtetëror.

Ne garantojmë përmirësimin e infrastrukturës fizike për sportin kosovar duke rinovuar kapacitetet ekzistuese dhe ndërtuar objekte tjera për përmbushjen e nevojave në këtë sferë. Ndërtimi i një stadiumi të madh kombëtar me kapacitet prej 70.000 personave do të realizohet gjatë qeverisjes së AKR-së.

AKR përkushtohet ndaj përmirësimit të programeve sportive nëpër gjitha nivelet e arsimit në Kosovë, sidomos në atë fillor dhe të mesëm, ndërsa në nivel të universiteteve ne premtojmë krijimin e ligave sportive joprofesionale në të gjitha fushat kryesore të sportit kosovar.

Identifikimi dhe përkrahja e talenteve në të gjitha fushat e sportit do të jetë prioritet i AKR-së për ti nxitur përmirësimin e rezultateve të tyre dhe motivuar të tjerët të ndjekin rrugën e njëjtë. Ne do të përkrahim sidomos individët dhe ekipe të cilat përfaqësojnë Kosovën në aktivitete të ndryshme garuese dhe jogaruese.

Institucionalizimi dhe rivendosja e rregullit në të gjitha degët e sportit kosovar është prioritet i AKR-së në këtë sferë dhe sidomos eliminimi i korrupsionit dhe keqpërdorimeve në sportin kosovar. Përkrahje e veçantë do ti jepet sportit të skisë dhe do ta bëjmë një plan për investime kapitale me qëllim të kthimit të renomesë dhe promovimit të kapaciteteve të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

AKR siguron përmirësimin dhe shtimin e kuadrit menaxhues, e sidomos mundësimin e përgatitjes profesionale të trajnerëve dhe referëve sportiv nëpër shkolla adekuate, me qëllim të eliminimit të dukurive negative në sportin kosovar.

IV. Departamenti i Drejtësisë

AKR në fushën e sundimit të së drejtës do të përqendrohet në investimin dhe zhvillimin e tri shtyllave kryesore: plotësimin e infrastrukturës ligjore dhe zbatimin e ligjeve në praktikë; reformimin dhe forcimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial; dhe luftimin e kriminalitetit, krimit të organizuar dhe korrupsionit.

AKR do të shpejtoj procesin e nxjerrjes së ligjeve sistemore në Kosovë, duke i kushtuar rëndësi të posaçme zhvillimit paraprak të politikave legjislativë që përfshijnë analizimin e përshtatshmërisë, implikimet financiare dhe vlerësimet tjera të nevojshme për nxjerrjen dhe zbatimin e ligjeve në praktikë.

Gjatë plotësimit të infrastrukturës ligjore, AKR do të siguroj harmonizimin dhe pajtueshmërinë e ligjeve me *acquis communautaires* dhe do të krijoj një ambient të sigurt e të përshtatshëm juridik për të gjithë qytetarët dhe banorët e Kosovës pa asnjë dallim. Njëkohësisht, do të rishikojmë dhe amendojmë gjithë legjislacionin ekzistues duke ia përshtatur rrethanave të reja të krijuara në Kosovë dhe duke eliminuar pengesat dhe të metat aktuale.

AKR i jap prioritet sidomos plotësimit të infrastrukturës ligjore dhe krijimit të kushteve për tërheqjen dhe sigurimin e investitorëve të jashtëm, që janë të interesuar të investojnë në Kosovë. Prioritet në këtë drejtim është gjithashtu nxjerrja e ligjit për kthimin e pronave të ekspropriuara dhe nacionalizuara, për të krijuar një bazë të shëndoshë për shfrytëzimin e pronës në Kosovë. AKR do të caktojë një listë prioritare për nxjerrjen e ligjeve organike, duke marrë për bazë vlerësimin e gjendjes aktuale të infrastrukturës ligjore.

AKR do të siguroj zbatimin e ligjit në praktikë duke ndërtuar mekanizma të rinj dhe forcuar ato ekzistues për përkrahjen dhe jetësimin të dispozitave të përfshira në ligje. Në këtë drejtim, do të nxjerrim gjithë legjislacionin sekondar të nevojshëm, duke i marrë parasysh mekanizmat ekzistues që janë si garanci për zbatimin e tyre në praktikë.

Reformimi i mirëfilltë i sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial është prioritet i veçantë i AKR-së në fushën e sundimit të së drejtës ligjore. AKR angazhohet për sigurimin e një gjyqësori plotësisht të pavarur nga ndikimi dhe presioni politik, të qasshëm për të gjithë dhe të lirë nga korrupsioni.

AKR garanton përmirësimin e infrastrukturës fizike të gjykatave dhe aplikimin e të arriturave më të reja nga fusha e teknologjisë informative në të gjithë strukturën e sistemit gjyqësor, e posaçërisht në përmirësimin e punës dhe rritjen e efikasitetit të administratës së gjykatave.

Ne garantojmë një buxhet më të madh për sundimin e së drejtës dhe kjo nënkupton edhe përmirësimin e të ardhurave për të gjithë punëtorët e gjyqësorit dhe prokurorisë.

AKR do të ndajë mjete të mjaftueshme për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në gjyqësi dhe prokurori, përmes edukimit dhe trajnimit profesional afatgjatë, freskimit me kuadro të reja dhe përmirësimit të plan programeve për edukimin ligjor në universitete, duke siguruar përgatitjen adekuate të gjeneratave të reja.

Do të bëhet rishikimi i procedurës së emërimit dhe rrimërimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve tjerë kyç të sistemit të drejtësisë, në mënyrë që të kemi një gjyqësor efikas, të pavarur dhe në asnjë mënyrë të lidhur me rrjetet kriminale dhe praktikat korruptive. Kjo do të bazohet në një sistem hulumtues dhe gjithëpërfshirës të së kaluarës profesionale, etike dhe morale të këtyre punëtorëve. AKR siguron se do të ndërmerren masa ndëshkuese të ashpra ndaj gjithë atyre gjyqtarëve, prokurorëve dhe bartësve tjerë të sistemit gjyqësor për shkeljet dhe keqpërdorimin e detyrës së tyre.

AKR, përpos mekanizmave të rregullt institucional do të themeloj edhe një program të pavarur monitorues për gjyqësorin, që do të ndikoj në vëzhgimin, identifikimin e çështjeve që duhet adresuar dhe mbikëqyrjen e funksionimit të gjyqësorit në interesa të qytetarëve.

Forcimi i prokurorisë, funksionalizimi i prokurorisë speciale dhe krijimi i të gjitha kushteve për luftimin e kriminalitetit dhe kimit të organizuar është ndër qëllimet kryesore të AKR-së për Kosovën. Ne sigurojmë pjesëmarrjen e Kosovës në programe ndërkombëtare që ofrohen për luftimin e kimit të organizuar, trafikimi dhe terrorizmit në vendet e Evropës jug-lindore.

AKR, gjithashtu do ti ofroj bashkëpunim të plotë Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavi për ndjekjen dhe arrestimin e të dyshuarve për krime të luftës, si dhe do të bashkëpunoj me të gjitha instancat tjera ndërkombëtare për ndjekjen dhe kapjen e kryerësve të veprave tjera penale.

AKR do të fuqizoj Agjencinë Kosovare për Antikorrupsion për luftimin e kësaj dukurie në Kosovë dhe do ti siguroj mjete dhe mekanizma përcjellës për ushtruar punën në mënyrë të pavarur dhe pa presione politike. AKR përkrah përmirësimin e mëtejshëm të kualitetit dhe cilësisë së pjesëtarëve të forcave të sigurimit, duke ofruar të ardhura meditative për shkak të rrezikut permanent të cilit iu nënshtrohen dhe duke siguruar një skemë të qëndrueshme të sigurimit për jetë dhe sigurimit shëndetësor për rastet më të këqija dhe familjet e tyre.

Ne garantojmë sigurimin e të gjitha mjeteve dhe mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e kimit të organizuar, trafikimit, terrorizmit dhe krimeve ekonomike dhe ndëshkimin efektiv të kryerësve të tyre. Gjithashtu, AKR do të bëjë Kosovën pjesë të mekanizmave rajonale dhe ndërkombëtare për bashkëpunim në luftimin e këtyre dukurive. AKR do të rritë fondet për përmirësimin dhe ndërtimin e objekteve ndëshkuese e përmirësuese, duke krijuar hapësirë të mjaftueshme për të gjitha kategoritë e të arrestuarve dhe dënuarve, si dhe për të mundësuar vendosjen e tyre në bazë të kritereve të përcaktuara me ligj. Ne gjithashtu do të krijojmë programe trajnimi, edukimi dhe angazhimi në punë për të gjithë ata që plotësojnë kushtet dhe janë të interesuar të aftësohen gjatë qëndrimit të tyre në këto institucione.

V. Departamenti i Mbrojtjes dhe Sigurisë

AKR garanton forcimin e boshtit të Kosovës, sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit. Ne premtojmë një sistem të sigurisë kombëtare në të cilën garantohet mbrojtja e kufijve të Kosovës dhe rendi Kushtetues; liria; pavarësia; tërësia territoriale dhe sovraniteti i shtetit të Kosovës; funksionimi i shtetit ligjor; rendi, qetësia dhe ambienti i pastër jetësor dhe stabiliteti politik dhe mirëqenia sociale.

AKR garanton se do të ndikoj pozitivisht në fokusin e punëve të të gjitha strukturave të sigurisë së Kosovës, që rrjedhin nga ambienti i ri gjeopolitik i sigurisë, i krijuar si rezultat i ndryshimeve të natyrës së rreziqeve (nga ato tradicionale ushtarake në rreziqe të tjera jo-tradicionale e jo-simetrike).

AKR premtan që të mbroj integritetin territorial të Kosovës dhe mbrojtjen e popullit të saj. Dy shtyllat kryesore që ne i konsiderojmë si kyçe për mbrojtjen dhe sigurinë e Kosovës janë siguria e brendshme dhe faktorët e jashtëm që rrezikojnë sigurinë e brendshme.

AKR premtan ndalimin e faktorëve që cenojnë sigurinë e brendshme të Kosovës siç janë sundimi i dobët i ligjit, krimi i organizuar, enklavizimi dhe mos inkuadrimi i serbëve në sistemin e sigurisë, paqëndrueshmëria politike, dhuna ndëretnike, zhvillimi i strukturave paraushtarake, mundësia e pranisë së terrorizmit vendor, demonstratave, trazirave, fatkeqësitë e ndryshme natyrore dhe të tjera të përmasave të gjëra.

AKR zotohet që pas pavarësisë së Kosovës dhe njohjes ndërkombëtare të saj si shtet sovran, në Kosovë të ketë edhe për një kohë prani të forcave ushtarake ndërkombëtare mbi të cilat do të bie siguria e jashtme. Arkitektura e sigurisë dhe mbrojtjes së Kosovës duhet të ngrihet dhe zhvillohet si arkitekturë e veçantë me gjithë specifikat e veta, por njëherësh edhe si pjesë e arkitekturës së sigurisë rajonale e globale në rendin e sigurisë që po ndërtohet.

AKR me mbështetjen e faktorit ndërkombëtar do të ndërtojë forcën e sigurisë dhe mbrojtjes të Kosovës. Kjo forcë do të arrihet mbi bazën e së drejtës ndërkombëtare duke nënshkruar marrëveshje me NATO-n, marrëveshjet për “Siguri Kolektive” (p.sh. me OKB-në), si dhe “Siguria Bashkëpunuese” (e cila mund të nënshkruhet me palë të tjera-shtete apo palë tjetër).

AKR garanton investime në këto fusha për sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit: aftësimin dhe përgatitjet e komisioneve për Kuvendin e Kosovës dhe për këshillat komunale të sigurisë; aftësimin e kapaciteteve të zyrtarëve qeveritarë për sferën e sigurisë; aftësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të aktorëve joqeveritarë në sektorin e sigurisë; aftësimin dhe ngritjen e kuadrove të reja profesionale në sferën e sigurisë dhe mbrojtjes, në kuadër të sistemit ekzistues të arsimit universitar të Kosovës apo promovimin e studimeve tjera adekuate nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes.

AKR premtan krijimin e institucioneve të reja me qëllim që të zgjeroj institucionet ekzistuese të sigurisë së Kosovës. Institucionet e reja të sigurisë do të përfshijnë Këshillin e Sigurisë së Kosovës, Departamenti i Mbrojtjes, Ushtria e Kosovës dhe Shërbimin Inteligjent të Kosovës.

AKR garanton që ushtria e Kosovës do të jetë forcë elite e pajisur me armatim modern. Ne garantojmë që Kosova do të ketë edhe trupat rezervë të ushtrisë që së bashku me trupat elite do qëndrojnë në gatishmëri të ndihmojnë Kosovën dhe popullin kosovar për situata emergjente duke përfshi edhe katastrofat natyrore.

AKR premtan paraprakisht rolin dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Kosovës në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë; rolin dhe përgjegjësitë e Komisionit për siguri dhe mundësinë për themelimin e nën komisioneve për mbikëqyrjen e politikave dhe të buxhetit në fushat specifike të sigurisë, siç është menaxhimi i katastrofave; mundësinë për krijimin e komisioneve të tjera të Kuvendit me mandate të caktuara; mundësinë që edhe në kuvendet komunale të themelohet komision për siguri, që do të përbëhet nga këshilltarët e

Kuvendit Komunal, gjë që do ta rrisë llogaridhënien dhe do të sigurojë struktura të mirëfillta të mbikëqyrjes dhe të sigurisë në nivel lokal.

Në planin politik AKR do të angazhohet për shmangien e sundimit autokrat në sferën e sigurisë; për forcimin e kontrollit parlamentar në fushën e sigurisë, sidomos në drejtim të kontrollit mbi mjetet buxhetore, krijimit të parametrave ligjorë për çështjet e sigurisë.

AKR garanton për forcimin e rolit dhe pozitës së qytetarëve në sferën e sigurisë përmes urës lidhëse parlamentar – qytetar (për faktin se parlamentari ka mundësi që të dëgjojë dhe të ndiejë drejtpërdrejt vullnetin e qytetarit). Në këtë urë AKR garanton forcimin e planit funksional dhe organizativ të institucioneve qeverisëse; bashkërenditjen e përgjegjësive midis shtyllave kryesore qeverisëse; një politikë të sigurisë të efektshme, me në qendër të saj qytetarët gjithnjë duke e forcuar lidhjen e institucioneve qeverisëse (duke u lidhur institucionet në pjesën e tyre organizative dhe funksionale krijohet hapësira për sjelljen edhe të qytetarit në qendër të sferës së sigurisë).

AKR garanton afrimin e përgjegjësive dhe forcimin e lidhjeve midis institucioneve qeverisëse me ato të sigurisë, miks-qeverisje - “civilokraci – militokraci” mbi bazën e parimeve që rregullojnë marrëdhëniet demokratike mes civilëve dhe ushtarakëve si në vijim: shteti është i vetmi aktor në shoqëri që ka monopolin e ligjshëm të forcës; shërbimet e sigurisë japin llogari para autoriteteve të ligjshme demokratike; parlamenti është sovran dhe i kërkon llogari Ekzekutivit rreth politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes; parlamenti ka një rol të vetëm dhe vendimtar në lidhje me shpalljen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme ose të gjendjes së luftës dhe kontrollin mbi shpenzimet e mbrojtjes dhe sigurisë; parimet e mirëqeverisjes edhe për fushën e sigurisë; personeli i angazhuar në fushën e sigurisë jep llogari individualisht para trupit gjyqësor.

AKR premtan që organizimet në fushën e sigurisë të janë asnjëse nga pikëpamja politike, në veçanti: për ndërtimin dhe ngritjen e arkitekturës së sigurisë konform pikëpamjeve dhe orientimeve programore politike të politikës së AKR-së.

AKR premtom ndarjen e roleve mbi bazën e përgjegjësiwe të përbashkëta të hallkave të qeverisjes, në veçanti që Ekzekutivi, Legjislativi dhe Gjyqësori të luajnë role të rëndësishme në lidhje me politikën e sigurisë kombëtare.

AKR premtom që kompetenca dhe përgjegjësi të veçanta në drejtimin dhe udhëheqjen me fushën e sigurisë t'i përkasin Presidentit (në sistemin presidencial të qeverisjes – tip i qeverisjes mbi bazën e platformës së AKR-së) dhe Ekzekutivit – kreut të shtetit, Parlamentit dhe Shtabit të Përgjithshëm.

AKR premtom që shërbimet e sigurisë t'u japin llogari institucioneve shtetërore të qeverisjes dhe që shoqëria civile gjithashtu të ketë pjesën e vet të rolit dhe përgjegjësiwe nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes.

VI. Departamenti i Politikave të Jashtme

Thelbi i vizionit të AKR-së në politikat e jashtme qëndron në ruajtjen dhe forcimin e paqes dhe stabilitetit në vend dhe rajon, mbrojtjen dhe avancimin e interesave të Kosovës në sferën ndërkombëtare, promovimin a imazhit të Kosovës dhe kosovarëve jashtë vendit.

AKR e ka të qartë se Kosova si vend i vogël ka nevojë për sa më shumë miq dhe aleatë, andaj politikat tona në sferën ndërkombëtare do të jenë politika të përafrimit dhe integritit, politika të krijimit të raporteve të shëndosha si me vendet evropiane ashtu edhe më gjerë, por padyshim se rol kryesor do t'i kushtohet përforcimit të raporteve me SHBA-të si aleat kryesor. Nisur nga rëndësia që AKR i kushton krijimit të raporteve miqësore, do të krijojmë një grup të veçantë ekspertësh në nivel qendror, synim i vetëm i të cilit do të jetë lobimi për miq të ri të Kosovës dhe përforcimi i miqësisë dhe aleancave ekzistuese.

Raportet e bashkëpunimit me vendet e jashtme do të ndërtohen në parimin e barazisë dhe respektit të ndërsjellë. Në raport me rajonin AKR është e vetëdijshme për karakterin multietnik të të gjitha vendeve në Ballkan, andaj politikat tona të përforcimit të miqësisë mbështeten në principin e respektimit të plotë dhe reciprok të të drejtave të të gjitha minoriteteve. AKR premtan se do të krijoj të gjitha hapësirat e nevojshme për trajtim të barabartë të të gjithë qytetarëve të saj, dhe do të kërkojë trajtim të njejtë për minoritetet edhe nga shtetet fqinje. AKR synon Kosovën si faktor stabiliteti në rajon.

AKR synon arritjen e prioriteteve të saja kyçe si rritja ekonomike, krijimi i vendeve të punës dhe siguria përmes integritit në mekanizmat ndërkombëtar të bashkëpunimit dhe sigurisë. Poashtu do të bëhemi pjesë aktive e të gjitha iniciativave që synojnë integritin dhe përafrimin e ekonomive dhe shoqërive të Ballkanit. Në secilin rast AKR premtan gadishmëri të plotë për të pranuar dhe kompletuar të gjitha detyrat dhe obligimet që rrjedhin nga përpjekjet për integritin.

Synimet e AKR-së në politikat e jashtme përfshijnë:

- Forcimin e pozitës së Kosovës në rajon dhe Evropë si faktor stabilizues,
- Avancimin e proceseve integruese të vendit përfshirë këtu anëtarësimin në BE, Këshillin e Evropës, NATO, FMN, Bankën Botërore,
- Ruajtjen dhe forcimin e raporteve miqësore me vendet kyçe në politikën ndërkombëtare
- Mbështetjen e përpjekjeve dhe operacioneve ndërkombëtare për luftimin e terrorizmit në nivel botëror
- Shfrytëzimin e minoriteteve si ura miqësie drejt marrëdhënieve të shëndosha me të gjitha vendet fqinje
- Shfrytëzimi i diasporës Kosovare si mekanizëm për promovimin e imazhit të Kosovës dhe kosovarëve
- Krijimin e infrastrukturës diplomatike me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të Kosovarëve jashtë, ruajtjes së vazhdueshme të lidhjes së tyre me Kosovën dhe gjetjen e mënyrave për ngritjen e investimeve të diasporës në ekonominë kosovare.
- Shfrytëzimin e prezencës diplomatike ndërkombëtare për të mbështetur përpjekjet e komunitetit të biznesit për rritje të bashkëpunimit ekonomik,
- Shfrytëzimin e pozitës së Kosovës në rajon për krijimin e korridoreve që lidhin rajonin dhe mundësojnë promovimin e turizmit dhe ekonomisë vendore

Në tërë angazhimet tona ndërkombëtare prioritetet kyçe janë integrimi në BE në fushën ekonomike dhe integrimi në NATO në fushën e sigurisë. Në procesin e integritit në BE, AKR garanton angazhim maksimal në përmbushjen e obligimeve në fazën e parë të parafutjes në BE si dhe në fazën e obligimeve të dala nga marrëveshja për asociim dhe stabilizim. Përmes rritjes së qëndrueshme ekonomike, stabilizimit ekonomik dhe politik dhe konfrontimit të sinqertë me problemin e korrupsionit, ne do të krijojmë terrenin e domosdoshëm për nënshkrimin sa më të shpejtë të marrëveshjes së asociim stabilizimit me BE-në. Ndërlidhur me këtë janë edhe përpjekjet tona serioze për anëtarësim të plotë dhe sa më të shpejtë në Këshillin e Evropës.

Në sferën e sigurisë, AKR angazhohet për futje të shpejtë në programin e NATO-s, “Partneriteti për paqe” si hap i parë drejt anëtarësisë së plotë në NATO. Pa marrë parasysh kohën e anëtarësimit, AKR garanton trajtim kontinual të privilegjuar për të gjitha trupat e NATO-s në shenjë mirënjohje të thellë për kontributin e shtrenjtë të këtij institucioni në arritjen e paqes dhe lirisë në Kosovë. Poashtu qeveria e udhëhequr nga AKR i garanton mbështetje aktive NATO-s në të gjitha operacionet e saja në shërbim të paqes dhe stabilitetit.

AKR njëherit ofron seriozitet të plotë në aktivitetet për anëtarësim dhe bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare apo aleancat e bashkëpunimit si FMN, Banka Botërore, EBRD, EIB, OBT, Grupi i Shangait e të tjera. Me të gjitha këto institucione do të ndërtojmë raporte të mirëfillta të bashkëpunimit, raporte këto që reflektojnë dhe respektojnë sovranitetin e vendit dhe përgjegjësinë primare të qeverisë sonë ndaj qytetarit.

AKR poashtu garanton bashkëpunim të plotë me të gjitha organizatat dhe institucionet ndërkombëtare që angazhohen për të drejtat e njeriut, për lirinë e fjalës, për lirinë e besimit fetar, mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen dhe avancimin e rolit të gruas në shoqëri, mbrojtjen e familjes, mbrojtjen e ambientit, luftimin e varfërisë e të tjera. Nisur nga fakti se qytetarët e Kosovës i takojnë besimeve të ndryshme fetare, AKR ndjek principin e respektimit të plotë të të gjitha lirive fetare, dialogut mes religjioneve dhe gjetjen e urave të bashkëpunimit mes tyre.